



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës, Ministarstvo Infrastrukture, Ministry of Infrastructure

Nr. 132 /2017
Datë: 11.01

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare nr.82, datë 21 tetor 2010), nenit 128 të Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer, nenit 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në bazë të nenit 5 (paragrafi 5.4.c) të Rregullores nr.2001/19 për Degën e Ekzekutivit, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike) të publikoj pyetjet për dhënien e provimit për patentë shofer për kategorinë “B” në web faqen e Ministrisë së Infrastrukturës.
- II. Pyetjet për dhënien e provimit për patentë shofer për kategorinë “B” janë pronë e Ministrisë së Infrastrukturës.
- III. Ndalohet çdo lloj publikimi, kopjimi, shpërndarje në mënyrë fizike apo elektronike të pyetjeve të cekura në pikën I të këtij vendimi apo çfarëdo forme tjetër e përfitimit material nga personat fizik apo juridik.
- IV. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dergohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të FSHP;
- Divizionit për Zhvillim dhe Përgaditjen e Testeve për Patent Shofer;
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike dhe
- Arkivit të MI-së.



1001. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Anashkalimin e obliguar nga ana e majtë.
- Në përshtatje të shpejtësisë.
- Vendkalimin e shënuar për këmbësorë.



1002. Çfarë domethënie kanë dritat në semafor?

- Kalimi i lirë, por me kujdes të shtuar.
- Përgatitje për nisje.
- Së shpejti do të ndizet drita e gjelbër.



1003. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Duhet të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi këmbësorit.
- Do të vazhdoj lëvizjen djathtas pa u ndalur, por me kujdes të shtuar.
- Do të sinjalizoj me tregues të drejtimit kthimin djathtas.




1004. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në vendkalim të këmbësorve.
- Këmbësorët mund të hyjnë në vendkalim që të kalojnë rrugën.
- Sipas nevojës, do ta zvogëloj shpejtësinë dhe do të jam i gatshëm për frenim.



1005. A ju lejohet ndërrimi i shiritit për kthim majtas, në këtë situatë?

- Po, nëse nuk pengohen mjetet që lëvizin prapa.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, duhet të sinjalizoj veprimin me treguesit e drejtimit.



1006. Rruga ka dy shirita të trafikut në një kah të lëvizjes. A ju lejohet tejkalimi në kthesa të padukshme?

- Jo, në asnjë rast.
- Po, një veprim i tillë lejohet me rregullat e trafikut.
- Jo, vetëm gjatë kushteve të vështira atmosferike.



1007. Çfarë kujdesi do të keni në këtë situatë?

- Do të vazhdoj lëvizjen me shpejtësi të zvogëluar.
- Në këmbësorët që dalin prapa autobusit dhe mund ta kalojnë rrugën.
- Në këmbësorët që mund të dalin përpara autobusit për ta kaluar rrugën.



1008. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në zvogëlim të shpejtësisë së lëvizjes dhe do të rris kujdesin.
- Do të jem i gatshëm të reagoj në rast nevoje.
- Do të përdori shenjën akustike (borinë) që këmbësorët të largohen nga rruga.



1009. Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjes në këtë situatë?

- Në punimet në rrugë.
- Në kufizim të shpejtësisë së lëvizjes.
- Në ngushtim rruge nga ana e majtë.



1010. A ju lejohet tejkalimi i kolonës së mjeteve?

- Po, nëse nuk pengohen mjetet nga prapa.
- Po, sepse nuk ka mjete nga kahu i kundërt dhe me shenja nuk është i ndaluar.
- Jo, në asnjë rast.



1011. A duhet vendosur trekëndëshin e sigurisë pas automjetit të ndaluar në defekt në autoudhë?

- Po, në largësi prej 30 - 50 metrash pas mjetit të ndalur.
- Jo, nëse rruga është me dukshmëri të mirë.
- Po, në largësi prej së paku 100 metrash.



1012. Cilat veprime ju ndalohen në autoudhë?

- Lëvizja me shpejtësi deri në 130 km/h.
- Lëvizja me shpejtësi mbi 130 km/h.
- Kthimi gjysmërrethor.



1013. Shoferi ka parkuar automjetin e udhëtarëve (veturën) në situatën si në foto. Si e vlerësoni këtë veprim ?

- Drejt.
- Jo drejt.
- Në kundërshtim me rregullat e trafikut.



1014. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi këmbësorit.
- Vazhdimin e lëvizjes pa u ndalur.
- Me shenjë akustike (bori) do të lajmëroj këmbësorin të largohet nga rruga.



1015. Çfarë kujdesi duhet të keni në rast të tejkalimit në situatën si në foto?

- Distanca anësore duhet të jetë së paku 1.5m.
- Distanca anësore duhet të jetë së paku 1m.
- Do të sinjalizoj veprimin me tregues të drejtimit.



1016. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të mbaj distancë të mjaftueshme të sigurisë.
- Do të përdor shenjën akustike (borinë) për t'u larguar kafshët nga rruga.
- Do të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes, sipas nevojës do të ndalem.



1017. Çfarë paralajmëron shenja e trafikut në këtë situatë?

- Vendin ku gjendet vendndalja e autobusit.
- Vendin për ndalje të detyrueshme të mjetit.
- Vendin ku gjendet vendndalja e tramvajit, autobusit dhe mjeteve tjera të transportit publik.



1018. Cilat veprime janë të lejuara në këtë pjesë të rrugës?

- Lëvizja me shpejtësi mbi 80 km/h.
- Lëvizja me shpejtësi deri në 80 km/h.
- Tejkalimi.



1019. A lejohet parkimi i mjetit në trotuar, në këtë situatë?

- Jo, pasi pengohet dhe rrezikohet trafiku.
- Po.
- Po, sepse nuk ka këmbësorë në rrugë.



1020. Cilat veprime ju ndalohen në këtë situatë?

- Ndalja dhe parkimi i mjetit.
- Tejkalimi.
- Lëvizja me shpejtësi deri në 40 km/h.



1021. Autobusi hyn në shiritin e trafikut nga vendndalja e autobusit jashtë zonës urbane. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Kam përparësi kalimi ndaj autobusit.
- Duhet t'ia mundësoj autobusit hyrjen në trafik.
- Do të vazhdoj lëvizjen me kujdes të shtuar, pasi që këmbësorët mund të dalin në rrugë.



1022. Çka duhet të kemi parasysh në këtë situatë?

- Në zvoglim të distancës së sigurisë ndaj mjetit që lëviz para meje.
- Në përdorimin e pajisjeve dimërore.
- Në distancë të sigurisë prej së paku 3 sekondash.



1023. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë ?

- Do t'i jap përparësi kalimi këmbësorit.
- Në shenjë të trafikut “Afërsi e kryqëzimit me rrethrotullim”.
- Në kryqëzim ku lejohet tejkalimi.



1024. A i lejohet automjetit të udhëtarëve (veturës) parkimi në këtë situatë?

- Po, pasi që rruga ka hapsirë të mjaftueshme.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse parkimi zgjat jo më shumë se 3 minuta.



1025. Cilat veprime ju lejohen në këtë situatë?

- Lëvizja drejt duke respektuar semaforin.
- Lëvizja djathtas duke mos respektuar semaforin por shenjën e trafikut.
- Lëvizja drejt dhe djathtas çdo herë duke respektuar vetëm semaforin.



1026. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në respektim të shpejtësisë maksimale të lëvizjes.
- Në ndalim të tejkalimit.
- Fillon autoudha nga shenja e trafikut.



1027. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të respektoj shenjat e trafikut.
- Do t'i jap përparësi kalimi mjeteve të cilat lëvizin në kryqëzim.
- Kam përparësi kalimi në raport me mjetet që lëvizin në kryqëzim.



1028. Pse distanca e sigurisë duhet të jetë më e gjatë gjatë lëvizjes në rrugë me borë?

- Rruga e frenimit është më e gjatë.
- Rruga e ndaljes është më e gjatë.
- Rruga e reagimit është më e gjatë.



1029. A ju lejohej tejkalimi në këtë situatë?

- Jo, është e ndaluar me sinjalzim horizontal.
- Po, vetëm automjetin e parë.
- Po, rruga nga kahu i kundër është e lirë.



1030. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të vazhdoj lëvizjen me kujdes të shtuar, sipas nevojës do të ndalem.
- Do të përdor shenjën akustike dhe nuk do të ndalem.
- Do t'u jap përparësi kalimi këmbësorëve.



1031. Autobusi është ndalur në vendndalje, në rrugë jashtë zoneve urbane. Çka duhet të keni parasysh?

- Në udhëtarët të cilët mund të dalin pas autobusit.
- Në udhëtarët të cilët mund të dalin para autobusit.
- Me shpejtësi të zvogëluar dhe kujdes të shtuar do ta vazhdoj lëvizjen.



1032. Në cilat raste lejohej përdorimi i shiritit nr. 1 në autoudhë?

- Për lëvizjen e mjeteve të cilat nuk mund të lëvizin me shpejtësi mbi 60 km/h.
- Për tejkalim të automjetve të cilat lëvizin shumë ngadal.
- Për ndalje të detyrueshme në rast të defektit në automjet.



1033. Gjatë lëvizjes në autoudhë si në këtë situatë, nëpër cilin shirit të trafikut duhet të lëvizni?

- Në shiritin nr 1.
- Në shiritin nr 2.
- Në shiritin nr 3, nëse është i lirë.



1034. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të ndalem, derisa të kalojnë këmbësorët.
- Do të lëviz me kujdes të shtuar.
- Do të vëzhgoj (përcjell) këmbësorët në trotuar.



1035. Cilat veprime ju lejohen në këtë situatë?

- Ndërrimi i shiritit djathtas.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Lëvizja drejt.



1036. Çka duhet të keni parasysh në rast të tejkalimit të biçiklistit?

- Distanca anësore nuk duhet të jetë më e vogël se 1 metër.
- Distanca anësore nuk duhet të jetë më e vogël se 1.5 metra.
- Do t'i ndez të gjithë treguesit e drejtimit.



1037. Shoferi i automjetit të udhëtarëve (veturës) tejkalon bashkësinë e mjeteve, në këtë situatë. Si e vlerësoni këtë veprim?

- Jo të drejt.
- Të drejtë, sipas rregullave të trafikut.
- Në kundërshtim me rregullat e trafikut.



1038. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem para vendkalimit të këmbësorëve, për t'i dhënë përparësi kalimi këmbësorit.
- Do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur, këmbësori është duke lëvizur shumë ngadal.
- Do të vazhdoj lëvizjen pasi këmbësori të kaloj rrugën.



1039. Çfarë kujdesi duhet të keni në këtë situatë?

- Në përshtatje të shpejtësisë për shkak të kthesës djathtas.
- Nuk do të lëviz me shpejtësi më të madhe se 40 km/h.
- Në përshtatje të shpejtësisë për shkak të kthesës majtas.



1040. Çfarë kujdesi duhet të keni në këtë situatë?

- Në kryqëzim me rrugën e dorës së dytë nën kënd të ngushtë.
- Mund të has në mjetet që vijnë nga rruga e dorës së dytë.
- Në kryqëzim me rrugën e dorës së dytë në kënd të drejtë.



1041. Në çka duhet të llogaritni në këtë situatë?

- Në afërsi të ngushtim rruge nga dy anët.
- Në pjesën e rrugës ku ndalohet tejkalimi i automjeteve.
- Në afërsi të rrugës ku kanoset rreziku nga shembja e gurëve.



1042. Çfarë kujdesi do të keni në këtë situatë?

- Do të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi mjetit i cili vjen nga kahu i kundërt i lëvizjes.
- Do të vazhdoj lëvizjen para mjetit i cili vjen nga kahu i kundërt i lëvizjes.
- Në respektim të shenjës së trafikut.



1043. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të vazhdoj lëvizjen para veturës së kuqe.
- Do t'i jap përparësi kalimi veturës së kuqe.
- Në respektim të rregullës së krahut të djathtë.



1044. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në afërsi të kthesës së rrezikshme djathtas.
- Në afërsi të kthesës së rrezikshme majtas.
- Në ndalim të tejkalimit të automjeteve, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore.



1045. Shoferi e ka parkuar automjetin e udhëtarëve (veturën) në situatën si në foto. Si e vlerësoni këtë veprim?

- Drejt, nëse i ka të ndezur të gjitha treguesit të drejtimit.
- Jo drejt.
- Në kundërshtim me rregullat e trafikut.



1046. A ju lejohet tejkalimi i dy mjeteve njëkohësisht?

- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse rruga nga kahu i kundërt është e lirë dhe me shenja të trafikut nuk është i ndaluar.
- Jo, vetëm jashtë zonave urbane.



1047. Fëmijët ndodhen pranë rrugës. Çfarë kujdesi do të keni në këtë situatë?

- Sipas nevojës do të zvogëloj shpejtësinë.
- Të mos i rrezikoj këmbësorët.
- Në vëzhgim të situatës, pasi që fëmijët mund të dalin në rrugë.



1048. Jashtë zonës urbane në rrugën nacionale e keni ndaluar mjetin për shkak defektit. Çfarë kujdesi duhet të keni?

- Në ndezjen e të gjithë treguesve të drejtimit.
- Në vendosjen e trekëndëshit të sigurisë prapa mjetit në distancë së paku 100 metra.
- Në vendosjen e trekëndshit të sigurisë prapa mjetit në distancë prej 30 - 50 metra.



1049. Si do të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem prapa autobusit dhe të pres derisa të niset nga vendndalja e tij.
- Duhet të vazhdoj lëvizjen me shpejtësi të rritur, pasi që autobusi është i ndalur në vendaljen për autobusë.
- Do të vazhdoj lëvizjen me kujdes të shtuar.



1050. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në vendkalimin hekurudhor pa mbrojtës ose gjysmëmbrojtës.
- Në vendkalimin hekurudhor me mbrojtës ose gjysmëmbrojtës.
- Në vendkalimin hekurudhor të rregulluar me shenja ndriçuese.



1051. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Përparësia e kalimit gjatë përballëkalimit është rregulluar me shenja të trafikut.
- Jam i obliguar të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi mjetit i cili lëvizë nga kahu i kundërt.
- Kam përparësi kalimi në raport me mjetin i cili lëviz nga kahu i kundërt.



1052. Çfarë kujdesi do të keni në këtë situatë?

- Do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur, pasi që rruga është e lirë.
- Do të respektoj shenjën e trafikut.
- Do t'i jap përparësi kalimi rrugës tërthore.



1053. A ju lejohej tejkalimi i mjetit në këtë situatë?

- Po, nga të dy anët.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, vetëm nga ana e djathtë.



1054. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Vetëm në ndalim të parkimit.
- Në ndalim të ndaljes dhe parkimit.
- Në distancë të sigurisë ndaj mjetit i cili lëviz përpara.



1055. Çfarë kujdesi duhet të keni në këtë situatë?

- Më lejohej lëvizja drejt dhe djathtas.
- Në vendkalim të këmbësorëve.
- Më lejohej ndërrimi i shiritit.



1056. Çfarë kujdesi duhet të keni në këtë situatë?

- Unë kam përparësi kalimi në raport me mjetet të cilat lëvizin në kryqëzim me rrethrotullim.
- Në kryqëzim ku lejohej tejkalimi.
- Mjetet të cilat lëvizin në kryqëzim me rrethrotullim kanë përparësi kalimi.



1057. A ju lejohet tejkalimi i mjetit në këtë situatë?

- Po, pasi që nuk ka trafik nga kahu i kundërt.
- Jo.
- Po, pasi që nuk e kam të ndaluar me shenja në rrugë.



1058. Si do të veproni në situatën si në foto?

- Do të lëviz me shpejtësi të rritur para se të hyjë autobusi në shiritin e trafikut.
- Do të mundësoj hyrjen e autobusit në shiritin e trafikut.
- Do të rris kujdesin pasi që këmbësorët mund të dalin në rrugë.




1059. Në semafor ndriçon drita e verdhë vezulluese. A ju lejohet kthimi djathtas?

- Jo, në asnjë rast.
- Po, unë kam përparësi kalimi në raport me këmbësorët të cilët janë duke kaluar rrugën.
- Po, por duhet dhënë përparësi kalimi këmbësorëve të cilët janë duke kaluar rrugën.



1060. Nga cila anë ju lejohet anashkalimi në këtë situatë?

- Nga ana e majtë.
- Nga ana e djathtë.
- Vetëm nga ana e majtë.



1061. A ju lejohet tejkalimi në këtë situatë?

- Jo, pasi që është në kundërshtim me shenjat në rrugë.
- Po, pasi që nuk e kam të ndaluar me shenjat në rrugë.
- Po, pasi që nga kahu i kundërt rruga është e lirë.



1062. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në vendkalim të këmbësorëve.
- Më lejohet lëvizja drejt.
- Më lejohet lëvizja djathtas.



1063. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të përdor shenjën akustike (borinë) për ta paralajmëruar këmbësorin të largohet nga rruga.
- Do të vazhdoj lëvizjen pasi të kalojë këmbësori.
- Do të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi këmbësorit.




1064. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të lëviz me shpejtësi të zvogëluar.
- Do të rris kujdesin, në rast frenimi rruga e frenimit është më e gjatë.
- Do të vazhdoj lëvizjen duke e rritur shpejtësinë, pasi që rruga është e lirë.



1065. Cilat veprime ju lejohen në këtë situatë?

- Kthimi majtas.
- Kthimi djathtas.
- Kthimi gjysmërrethor.



1066. A ju lejohet tejkalimi në këtë situatë ?

- Jo.
- Po, sipas rregullave të parapara të trafikut.
- Jo, me shenja në rrugë është i ndaluar.



1067. Në çka do të llogaritni në këtë situatë?

- Në distancë 80m nga vendkalimi hekurudhor.
- Në afërsi të vendkalimit hekurudhor pa mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.
- Në afërsi të vendkalimit hekurudhor me mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.



1068. A ju lejohet tejkalimi i motokultivatorit në këtë situatë?

- Po, nëse nuk i rrezikoj dhe pengoj pjesëmarrësit tjerë në trafik.
- Jo, është në kundërshtim me rregullat e trafikut.
- Po, vetëm gjatë lëvizjes brenda zonës urbane.



1069. Si do të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem para vendkalimit të këmbësorëve.
- Do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur.
- Do të përdor shenjën akustike që t'i paralajmëroj këmbësorët për prezencën time.



1070. A lejohet ndalja ose parkimi i automjetit në fushën për orientimin e trafikut rrugor ?

- Jo.
- Po, deri në tre minuta.
- Po, nëse i ka ndezur të gjithë treguesit e drejtimit.




1071. Çka duhet të keni parasysh në situatën si në foto?

- Në kryqëzim me rrugën me përparsi kalimi.
- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Për shkakë kushteve atmosferike, rruga e frenimit do të rritet.



1072. Si duhet vepruar shoferi i automjetit të udhëtarëve (veturës), deri sa jeni duke e tejkaluar?

- Nuk i lejohet rritja e shpejtësisë së lëvizjes.
- Të lëvizë sa më afër mesit të rrugës.
- Të lëvizë sa më afër skajit të djathtë të rrugës.



1073. Në semafor është e ndezur shigjeta e gjelbër. A ju lejohe lëvizja në këtë situatë?

- Po, djathtas duke iu dhënë përparësi kalimi të gjithë pjesëmarrësve në trafik.
- Jo, në asnjë drejtim.
- Po, djathtas, drejtë ose majtas.



1074. Çka duhet llogaritur në këtë situatë?

- Në kujdes të shtuar dhe do të vazhdoj lëvizjen me shpejtësi të zvogëluar.
- Do të përdor shenjën akustike (borinë) dhe do ta vazhdoj lëvizjen me shpejtësi të njëjtë.
- Këmbësorët mund të dalin në rrugë në mënyrë spontane.



1075. Si do të veproni në këtë situatë?

- Do të rris shpejtësinë e lëvizjes, fillon trafiku në autoudhë.
- Do të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes, përfundon trafiku në autoudhë.
- Do të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes, përfundon trafiku në rrugë nacionale.



1076. Në çka duhet të llogaritni në këtë situatë?

- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Mjetet të cilat lëvizin në rrethrotullim kanë përparësi kalimi.
- Në kryqëzim, ku lejohe tejkalimi.



1077. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në përshtatje të shpejtësisë për shkakë të kthesës.
- Afërsinë e kthesës në të djathtë.
- Në ndalim tejkalimi për të gjitha automjetet, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore.



1078. Kur duhet vendosur dy trekëndësha të sigurisë, si në foto?

- Me rastin e ndaljes së automjetit të udhëtarëve (veturës) në rrugë për shkak të defektit.
- Me rastin e ndaljes së kolonës së mjeteve në rrugë për shkak të defektit.
- Me rastin e ndaljes së mjetit në rrugë, i cili bart materiale të rrezikshme, për shkak të defektit.



1079. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes.
- Do të përshtas shkallën e transmisioni (ndërruesi i shpejtësisë).
- Nuk do të frenoj vullshëm.



1080. A ju lejohe tejkalimi i tramvajit në këtë situatë?

- Jo, në asnjë rast.
- Po, vetëm nga ana e djathtë.
- Po, nga cilado anë djathtas apo majtas.



1081. Nga shiriti i majtë i skajshëm, në cilat drejtime ju lejohet lëvizja?

- Majtas.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Drejt.



1082. Çka duhet të keni parasysh këtë situatë?

- Në respektim të semaforit.
- Duhet të ndalem para kryqëzimit.
- Nuk më lejohet ndërrimi i shiritave të trafikut.



1083. A ju lejohet tejkalimi në këtë situatë?

- Jo, pasi që e kam të ndaluar me shenja në rrugë.
- Jo, pasi që tejkalimi i kamionit është i ndaluar.
- Po.



1084. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në rast frenimi, automjeti mund të bartet.
- Duhet të lëviz me shpejtësi të rritur, sepse automjeti im është i pajisur me pneumatikë M+S.
- Në rast frenimi, rruga e ndaljes do të zgjatet.



1085. Çka paraqesin shenjat e trafikut dhe shenjat në rrugë në këtë situatë?

- Kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes.
- Rekomandim të shpejtësisë së lëvizjes.
- Kryqëzim me rrugën dytësore në kënd të drejtë, nga ana e majtë dhe nga ana e djathtë.



1086. Çfarë kujdesi duhet te keni në këtë situatë?

- Mund të has në kafshët shtëpiake në rrugë.
- Në zvogëlim të distancës së sigurisë ndaj mjetit që lëviz përpara.
- Për rrezikun në rrugë.




1087. A ju lejohej tejkalimi në këtë situatë?

- Jo.
- Po.
- Po, pasi që shenjat në rrugë e lejojnë tejkalimin.



1088. Si do të veproni nëse topi rrokulliset para jush?

- Do të zvogëloj shpejtësinë dhe do të jem i gatshëm për frenim, pasi që fëmijët mund të vrapojnë pas topit.
- Do ta përdor shenjën akustike (borinë) dhe do ta vazhdoj lëvizjen me shpejtësi të njëjtë.
- Pasi që fëmijët nuk gjenden në rrugë, do të vazhdoj me shpejtësi të rritur.



1089. Cilat veprime ju ndalohen në tunel?

- Kthimi gjysmërrethor.
- Lëvizja prapa.
- Ndalja dhe parkimi.



1090. Çfarë paraqesin shenjat e trafikut ?

- Ndalim ndalje.
- Pjesën e rrugës ku ndalohet qarkullimi i mjeteve në të dy kahet e lëvizjes.
- Pjesën e rrugës ku zhvillohet qarkullimi i mjeteve në të dy kahet e lëvizjes.



1091. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të përdor shenjën akustike dhe të vazhdoj lëvizjen.
- Do të zvogloj shpejtësinë e lëvizjes.
- Do të rris kujdesin dhe në rast nevojë do ta ndal mjetin.



1092. Si duhet shënuar automjeti i ndalur në autoudhë, për arsye defekti?

- Duhet vendosur trekëndëshin e sigurisë në largësi prej së paku 30-50 m, pas mjetit të ndalur.
- Duhet vendosur trekëndëshin e sigurisë në largësi prej së paku 100 m, pas mjetit të ndalur.
- Duhet ndezur të gjithë treguesit e drejtimit.



1093. Si duhet të veprohet në këtë situatë?

- Mjetet të cilat lëvizin pas autobusit duhet të ndalen derisa fëmijët të hipin ose zbresin nga autobusi.
- Mjetet të cilat lëvizin përballë autobusit duhet të vazhdojnë lëvizjen me shpejtësi të zvogëluar.
- Mjetet të cilat lëvizin përballë autobusit duhet të ndalen derisa fëmijët të hyjnë ose zbresin nga autobusi.



1094. Çfarë kujdesi duhet te keni në këtë situatë?

- Ndalim ndaljeje dhe parkimi për të gjitha automjetet.
- Kujdes të shtuar ndaj këmbësorëve.
- Ndalim ndaljeje dhe parkimi për kamionë dhe autobusë



1095. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të ndalem para vijës së ndaljes.
- Rruga është e lirë, do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur.
- Më lejohe lëvizja drejt dhe djathtas.



1096. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Më lejohe të vazhdoj lëvizjen vetëm drejt.
- Më lejohe ndërrimi i shiritit nëse nuk pengohen mjetet prapa.
- Nuk më lejohe ndërrimi i shiritit.



1097. Në çka do të llogaritni në këtë situatë?

- Në kthesë të rrezikshme majtas.
- Në ndalim tejkalimi.
- Në rritje të shpejtësisë në hyrje të kthesës.



1098. Si do të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem para vendkalimit të këmbësorëve.
- Do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur.
- Do të vazhdoj lëvizjen pasi të kalojnë këmbësorët.



1099. Çfarë kujdesi duhet të keni gjatë ngasjes në kushte të vështira atmosferike, nëpër mjegull?

- Do t'i përdor dritat e shkurtëra apo dritat e shkurtëra dhe dritat për mjegull.
- Do të lëviz me kujdes të shtuar, duke përshtatur shpejtësinë e lëvizjes.
- Do t'i përdor dritat e gjata për ndriçimin e rrugës, që rruga të shihet më mirë.



1100. A ju lejohet tejkalimi i qerres në këtë situatë ?

- Jo, në asnjë rast.
- Jo, tejkalimi i qerres është i ndaluar me shenja në rrugë.
- Po.



1101. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë ?

- Do të kaloj në shiritin e majtë.
- Do të përdor treguesin e drejtimit për ndërrim të shiritit.
- Nuk më lejohet ndërrimi i shiritit.



1102. Shoferi i automjeti të udhëtarëve (veturës) është duke kryer veprimin e tejkalimit si në foto. Si e vlerësoni këtë situatë ?

- Jo drejt.
- Drejt, pasi rruga është e lirë.
- Në kundërshtim me rregullat e trafikut.



1103. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Jam i obliguar të vazhdoj lëvizjen vetëm drejt.
- Duhet të bëj kthimin gjysmërrethor.
- Këmbësori papritmas mund të kalojë rrugën.



1104. Çka paraqesin shenjat e trafikut si në foto ?

- Udhëtregues mbi portal.
- Mbarimin e ndalimit të trafikut për mjetet e udhëtarëve (veturave).
- Mbarimin e motoudhës.



1105. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në punimet në rrugë.
- Në kufizim të shpejtësisë së lëvizjes.
- Në ngushtim rruge nga ana e majtë.



1106. Si duhet të veproni në këtë situatë?

- Do të përdor shenjën akustike për t'ua tërhequr vërejtjen këmbësorëve.
- Do të ndalem, për t'i lëshuar këmbësorët.
- Do të vazhdoj lëvizjen pa u ndalur fare.



1107. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në kthesë të dyfishtë apo kthesë të shumëfishtë, ku kthesa e parë është në të majtë.
- Në kufizim të shpejtësisë së lëvizjes.
- Në shpejtësi të rekomanduar të lëvizjes.



1108. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në shenjë të lajmërimit.
- Më lejohe të lëviz me shpejtësinë e lëvizjes së këmbësorit.
- Në pjesën e rrugës ku fëmijët mund të luajnë.



1109. Cilat veprime ju lejohen në këtë situatë?

- Lëvizja drejt.
- Lëvizja majtas.
- Kthimi gjysmërrethor.



1110. Cilat janë rreziqet e mundshme gjatë ngasjes si në këtë situatë (me shi)?

- Zvogëlohet (dobësohet) dukshmëria.
- Kontakti i gomave me rrugën zvogëlohet dukshëm.
- Në rast të frenimit zgjatet koha e reagimit.



1111. Si duhet të veprojë shoferi i automjetit A, kur është duke u tejkalar nga automjeti tjetër?

- Mund ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes, nëse nuk tejkalohe kufizimi maksimalë i shpejtësisë së lëvizjes.
- Nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes.
- Duhet të largojë mjetin e tij ka skaji i djathtë i rrugës.



1112. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në kufizim të shpejtësisë së lëvizjes.
- Në afërsi të kthesës së rrezikshme djathtas.
- Në respektim të shenjave të trafikut.



1113. Çka duhet keni parasysh në këtë situatë?

- Do t'i jap përparësi kalimi rrugës tërthore.
- Do të respektoj shenjën "Ndalje e obliguar".
- Detyrimisht do të kthehem majtas.



1114. Si duhet të veprojë shoferi i automjetit të bardhë, derisa tejkalohet nga mjete tjetër?

- Nuk i lejohet rritja e shpejtësisë.
- Duhet të skajohet sa më afër skajit të djathtë të rrugës.
- Duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.



1115. Çka duhet keni parasysh në këtë situatë?

- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Këmbësori papritmas mund të kalojë rrugën.
- Mjetet që lëvizin në rrethrotullim kanë përparësi kalimi.



1116. Çka duhet pasur parasysh në situatën si në foto?

- Më ndalohet kthimi djathtas.
- Duhet të lëviz drejtë.
- Mund ta ndërroj shiritin e trafikut.



1117. A lejohet ndalja e mjetit në rrugë, në këtë situatë?

- Po, nëse nuk pengohet trafiku.
- Po, vetëm brenda zonës urbane.
- Jo, në asnjë rast.



1118. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Më lejohet lëvizja drejt ose djathtas.
- Në respektim të semaforit.
- Duhet të ndalem para kryqëzimit.



1119. Si do të veproni në këtë situatë?

- Do të ndalem.
- Do të vazhdoj lëvizjen drejt ose djathtas.
- Do të vazhdoj lëvizjen vetëm majtas.



1120. Automjeti para jush ka dhënë treguesin e drejtimi për t'u kthyer majtas. A ju lejohet tejkalimi në këtë situatë?

- Jo.
- Po, nëse automjeti lëviz ngadalë.
- Po, pasi nuk është i ndaluar me shenja në rrugë.



1121. **Shoferi i automjetit të udhëtarëve hyn në trafik duke lëvizur prapa. Si e vlerësoni këtë situatë?**

- Drejt, nëse nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik.
- Drejt, nëse nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe i ndez të gjithë treguesit e drejtimit.
- Jo drejt.



1122. **Në semafor janë të ndezura dritat me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë në të njëjtën kohë. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?**

- Do të përgatitem për nisje.
- Duhet ta vazhdoj lëvizjen pa u ndalur me kujdes të shtuar.
- Do të pres deri sa të ndizet drita e gjelbër.



1123. **Çka duhet të keni parasysh në situatën si në foto ?**

- Rrugën me qarkullim në një kah të lëvizjes.
- Drejtim i obliguar drejt.
- Më ndalohet kthimi gjysmërrethorë.




1124. **Cili automjet është duke lëvizur drejt?**

- Automjeti nr. 1.
- Automjeti nr. 2.
- Automjeti nr. 3.



1125. Çka duhet të keni parasysh kur doni të hyni në trafik nga rruga e dheut, si në foto?

- Do t'i jap përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin në rrugë.
- Kam përparsi kalimi ndaj mjeteve të cilat lëvizin në rrugë.
- Do të sinjalizoj me tregues të drejtimit.



1126. A ju lejohet tejkalimi i motoçikletës në këtë situatë?

- Po, pasi që rruga është e drejtë.
- Jo.
- Po, nëse nuk i rrezikoj këmbësorët.




1127. Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjes në autoudhë?

- Më lejohet lëvizja deri në 130km/h
- Do të shfrytëzoj shiritin e djathtë të skajshëm nëse nuk është i zënë në kolonë.
- Do të shfrytëzoj shiritin për ndalje emergjente në rast defekti.



1128. Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjesi në këtë situatë?

- Në dukshmëri të dobësuar.
- Mund të mos vërehen me kohë këmbësorët dhe mjetet që nuk kanë ndriçim vetjak.
- Do të përshtas shpejtësinë dhe do të rris kujdesin.



1129. Çka lajmëron shenja e trafikut në këtë situatë?

- Nga largësia 150m nga shenja, qarkullimi i mjeteve fillon të zhvillohet në dy kahe të lëvizjes.
- Nga largësia 250m nga shenja, qarkullimi i mjeteve fillon të zhvillohet në dy kahe të lëvizjes.
- Duke filluar nga shenja, qarkullimi i mjeteve fillon të zhvillohet në dy kahe të lëvizjes.



1130. Çka duhet të keni parasysh në situatën si në foto?

- Do të rris distancën anësore të sigurisë.
- Do të zvogëloj shpejtësinë dhe do të jemi i gatshëm për frenim.
- Duhet të ndalem në vend deri sa të kalojnë fëmijët.



1131. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Do të përshtas shpejtësinë e lëvizjesë.
- Duhet ta vazhdoj lëvizjen pa u ndalur.
- Do të ndalem në rast nevojë për t'i dhënë përparsi kalimi automjetit të bardhë.



1132. Gjatë ngasjes keni hasur në situatën si në foto. Çka duhet të keni parasysh?

- Pas kthesës mund të gjendet ndonjë mjet i cili lëviz ngadal.
- Frenimin e vullshëm në mes të kthesës.
- Ndonjë mjet i cili lëviz në shiritin tim.



1133. Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjes si në foto?

- Në përdorim vetëm të dritave për shënimin e automjetit (pozicionit).
- Në përdorimin e dritave të shkurtëra.
- Në adaptimin e syve nga drita në errësi.



1134. Çfarë kujdesi duhet të keni në situatën si në foto?

- Në rritje të shpejtësisë në hyrje të kthesës.
- Pas kalimit të mesit të kthesës gradualisht e rris shpejtësinë.
- Në bartje te mjetit nëse shpejtësia është e papërshtatshme.



1135. Çka duhet të keni parasysh në situatën si në foto?

- Do të zvogëloj distancën anësore të sigurisë.
- Do të zvogëloj shpejtësin dhe do të jem i gatshëm për frenim.
- Nëse nuk ka mjete nga prapa, do të kaloj në shiritin e majtë.



1136. Çfarë kujdesi duhet të keni gjatë ngasjes së automjetit në këtë situatë?

- Në përshtatje të shpejtësisë së lëvizjes.
- Për rrezikun në rrugë.
- Në afërsinë e pjesës së rrugës të rrëshqitshme.



1137. Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjes jashtë zonës urbane (autobusi ka sinjalizuar për hyrje në shiritin e trafikut), në situatën si në foto?

- Jam i obliguar të ndalem për t'i dhënë përparësi kalimi autobusit.
- Do të vazhdoj lëvizjen me kujdes të shtuar.
- Kam përparësi kalimi në raport me autobusin.



1138. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Mund të dalë ndonjë këmbësor në mes mjeteve të parkuara.
- Nuk më lejohet lëvizja në shiritin rrugor për mjetet nga kahu i kundërt.
- Duhet të zvogëloj distancën e sigurisë ndaj mjetit që lëviz përpara.



1139. Çfarë kujdesi duhet të keni gjatë ngasjes jashtë zonës urbane në këtë situatë?

- Në distancë të sigurisë gjatësore.
- Në distancë të sigurisë së paku 30 deri 50 metra.
- Në fushëpamje të kufizuar.



1140. Çka duhet të keni parasysh në këtë situatë?

- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Mjetet që lëvizin në rrethrotullim kanë përparësi kalimi.
- Në kryqëzim ku ndalohet tejkalimii.



2001. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Rrezikun e përgjithshëm në rrugë.
- Trafiku zhvillohet në një kah.
- Ndalon trafikun në një kah.



2002. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e kthesës së rrezikshme majtas.
- Afërsinë e kthesës së rrezikshme djathtas.
- Qafë mali.



2003. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Kthesë e rrezikshme djathtas.
- Afërsinë e kthesës së rrezikshme majtas.
- Kthesa të njëpasnjëshme.



2004. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Rrezikun e përgjithshëm në rrugë.
- Kthesë të njëpasnjëshme e para në të djathtë.
- Kthesë të njëpasnjëshme e para në të majtë.



2005. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Ngushtim rruge.
- Trafiku zhvillohet në dy kahe të lëvizjes.
- Punimet në rrugë.



2006. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Ngushtim rruge nga krahu i djathtë.
- Ngushtim rruge nga krahu i majtë.
- Rrezikun në rrugë.



2007. Në cilin grupë të shenjave bën pjesë kjo shenjë e trafikut?

- Urëdhrove të prera.
- Të rrezikut.
- Të lajmërimit.



2008. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e pjesës së rrugës ku përgjatë rrugës është e dëmtuar bankina.
- Afërsinë e rrugës së rrëshqitshme.
- Rrezikun në rrugë.



2009. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Rrugën me gunga.
 Rrugën e rrëshqitshme.
 Afërsinë e bregut.



2010. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Vendkalimin hekurudhor të pasiguruar.
 Stacionin e tramvajit.
 Rrugë tramvaji.



2011. Në cilin grup të shenjave bën pjesë kjo shenjë?

- Të urdhrave të prera.
 Të lajmërimit.
 Të rrezikut.



2012. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Përplasje gurësh.
 Shembje gurësh.
 Rrugën me gunga.



2013. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e vendkalimit të shënuar për këmbësorë.
 Shtegun për këmbësorë.
 Afërsinë e fëmijëve në rrugë.



2014. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e fëmijëve në rrugë.
 Afërsinë e vendkalimit të shënuar për këmbësorë.
 Shtegun për fëmijë.



2015. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Biçiklistët në rrugë.
 Ndalim trafiku për biçiklistë.
 Shtegun për biçiklistë.



2016. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Egërsirat në rrugë.
 Kafshët në rrugë.
 Pjesën e rrugës ku ndalohet lëvizja e kafshëve pa mbikëqyrje.



2017. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Egërsirat në rrugë.
 Kafshët në rrugë.
 Vendin ku ndalohet kalimi i egërsirave.



2018. Cilit grup të shenjave i takon kjo shenjë e trafikut?

- Të urdhrave të prera.
 Të lajmërimit.
 Të rrezikut.



2019. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Kryqëzimin e rregulluar me semafor.
 Rrezikun në rrugë.
 Vendkalimin hekurudhor.



2020. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Ngushtimin e rrugës nga ana e djathtë.
 Ngushtimin e rrugës nga ana e majtë.
 Rrugën me trafik në një kah.



2021. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e bregdetit.
 Urën lëvizëse.
 Rrugën jo të rrafshhtë.



2022. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e bregdetit.
 Urën lëvizëse.
 Rrugën jo të rrafshhtë.



2023. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Përplasje gurësh.
 Rrugë e rrëshqitshme.
 Rrugë jo e rrafshhtë.



2024. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bënë pjesë?

- Afërsinë e pistës së aeroplanëve.
 Lajmërimit.
 Rrezikut.



2025. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Afërsinë e vendkalimit hekurudhor.
 Të lajmërimit.
 Të rrezikut.



2026. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Teposhtëze e rrezikshme.
 Përpjetëze e rrezikshme.
 Kthesa të rrezikshme.



2027. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e kryqëzimit me rrethrotullim.
 Afërsinë e kryqëzimit me shenja ndriçuese.
 Afërsinë e kryqëzimit të rregulluar me person të autorizuar.



2028. Çka tregon kjo shenjë e trafikut

- Trafiku zhvillohet në një kah.
 Trafiku zhvillohet në dy kahe.
 Rrugë me përparësi kalimi.



2029. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Pjesën e rrugës ku ekziston rreziku nga kolona e ndalur e mjeteve në rrugë.
 Distancën në mes mjeteve.
 Rrezikun në pjesën e rrugës ku mund të ketë ngrica në rrugë.



2030. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Afërsinë e vendkalimit hekurudhor me mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.
 Afërsinë e vendkalimit hekurudhor pa mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.
 Afërsinë e vendkalimit për tramvaj.



2031. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Lidhjen e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e ngushtë nga krahu i majtë.
 Lidhjen e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e ngushtë nga krahu i djathtë.
 Lidhjen e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejtë nga krahu i majtë.



2032. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Rrugën e tramvajit.
 Stacionin hekurudhor.
 Stacionin e tramvajit.



2033. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Vendin ku ekziston rreziku i rrëshqitjes, përmytjes së mjeteve.
- Parkimin e mjetit në trotuar.
- Afërsinë e vendit ku ka rrezik nga rrëshqitja e gurëve në rrugë.



2034. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kalimin e rrugës përtej hekurudhës me një palë binarë.
- Kalimin e rrugës përtej hekurudhës me dy palë binarë.
- Kryqëzimin e rrugës me rëndësi të njëjtë.



2035. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ardhjen e trenit.
- Kalimin e hekurudhës të rregulluar me shenja ndriçuese.
- Kalimin e hekurudhës pa u ndalur.



2036. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Të lajmërimit.
- Afërsinë e vendkalimit hekurudhor pa mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.
- Afërsinë e vendkalimit hekurudhor me mbrojtëse.



2037. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Rrezik nga zjarri.
- Kampin për pushim.
- Lulishte.



2038. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Erërat anësore.
- Pistën e aeroplanëve.
- Rrezikun nga zjarri.



2039. Çka duhet të keni parasysh te kjo shenjë e trafikut?

- Kryqëzimin e rrugës kryesore nën këndin e drejt.
- Në respektim të rregullës së krahut të djathtë.
- Kryqëzim të rrugëve me rëndësi të njëjtë.



2040. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Kryqëzimin e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejt.
- Ngushtim rruge nga dy anët.
- Rrezikun në rrugë.



2041. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Vendkalimin hekurudhor me një palë binarë.
- Vendkalimin hekurudhor me dy palë binarë.
- Vendkalimin hekurudhor me mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.



2042. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për këmbësorë.
- Ndalim trafiku për këmbësorë.
- Afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën lëvizin këmbësorët.



2043. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Vendkalimin hekurudhor me mbrojtëse ose gjysmëmbrojtëse.
- Të urdhrave të prera.
- Të rrezikut.



2044. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Vendkalimin hekurudhor.
- Rrezikun në rrugë.
- Tunelin apo galerinë në rrugë.



2045. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Kryqëzimin e rrugëve me rëndësi të njëjtë.
- Afërsinë e kryqëzimit me rrethrotullim.
- Zhvillimin e trafikut në dy kahe.



2046. Çka paralajmëron kjo shenjë e trafikut?

- Pjesën e rrugës e cila është jo e rrafshët.
- Pjesën e rrugës ku gurët mund të bien (shemben) në rrugë.
- Pjesën e rrugës në të cilën ekziston rreziku i papritur nga ngrica.



2047. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Punimet në rrugë.
- Përjetëse e rrezikshme.
- Teposhtëze e rrezikshme.



2048. Çka paraqet kjo shenjë dhe në cilin grup bën pjesë?

- Të rrezikut.
- Përjetëse e rrezikshme.
- Teposhtëze e rrezikshme.



2101. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalje e obligueshme.
 Ndalim trafiku në dy kahe.
 Dogana.



2102. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalje e obligueshme.
 Kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi.
 Rrugën me përparësi kalimi.



2103. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku në dy kahe.
 Ndalim trafiku në një kah.
 Rrugë me një kah.



2104. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku në dy kahe.
 Ndalim trafiku në një kah.
 Mbarim i të gjitha ndalesave.



2105. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalon trafikun për të gjitha mjetet me veprim motorik, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore.
 Ndalim trafiku vetëm për automjetet e udhëtarëve (vetura).
 Motoudhën.



2106. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shiritin e trafikut për autobusë.
 Ndalon trafikun për autobusë.
 Vendndalje për autobusë.



2107. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalon trafikun për të gjitha mjetet me veprim motorik.
 Shiritin e trafikut për kamionë.
 Ndalon trafikun për mjetet transportuese-kamionë.



2108. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për të gjitha mjetet me veprim motorik.
 Ndalim trafiku për mjete që bartin materie të rrezikshme.
 Ndalim trafiku për cisterna.



2109. Çka tregon kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Pjesën e rrugës ku lejohet lëvizja e këmbësorëve.
- Të urdhrave të prera.
- Ndalim trafiku për këmbësorë.

**2110. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë lartësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë masën e caktuar.

**2111. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë lartësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet tek të cilat tejkalojnë masën e caktuar.

**2112. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë lartësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë masën e caktuar.

**2113. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë lartësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë ngarkesën boshtore të caktuar.

**2114. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë lartësinë e caktuar.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjatësinë e caktuar.

**2115. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjerësinë e caktuar.
- Distancën më të vogël në mes mjeteve në lëvizje.
- Ndalim trafiku për mjetet të cilat tejkalojnë gjatësinë e caktuar.

**2116. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?**

- Ndalim kthimi djathtas.
- Ndalim kthimi majtas.
- Kthimi i obligueshëm majtas.



2117. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për automjetet e udhëtarëve (veturat) të cilat bartin ngarkesën mbi mjet.
- Ndalim trafiku për mjete që bartin materie të rrezikshme.
- Pjesën e rrugës ku duhet të lëvizin mjetet e udhëtarëve.



2118. Çka tregon kjo shenjë e trafikut, në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Ndalim trafiku për të gjitha mjetet motorike të cilat tërheqin mjetet bashkangjitime.
- Të urdhrave të prera.
- Të lajmërimit.



2119. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për traktorë.
- Pjesën e rrugës ku duhet të lëvizin traktorët.
- Ndalim trafiku për gjysmërimorkio.



2120. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për mopedë.
- Vendkalimin për biçikleta.
- Ndalim trafiku për biçikleta.



2121. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për biçikleta.
- Ndalim trafiku për motoçikleta.
- Ndalim trafiku për biçikleta.



2122. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për biçikleta.
- Pjesën e rrugës ku biçiklistët lëvizin në grupe.
- Ndalim trafiku për mopedë.



2123. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për qerre.
- Ndalim trafiku për kalorës.
- Pjesën e rrugës ku duhet të lëvizin qerret.



2124. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim trafiku për të gjitha mjetet me veprim motorik.
- Ndalim trafiku për biçikleta.
- Trafikun e mjeteve të përziera.



2125. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim kthimi djathtas.
- Kah i obliguar djathtas.
- Ndalim kthimi majtas.



2126. Çfarë na tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim kthimi djathtas.
- Ndalim kthimi majtas.
- Ndalim kthimi gjysmërrethor.



2127. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kufizimin maksimal të shpejtësisë.
- Shpejtësinë më të vogël të lejuar.
- Shpejtësinë që rekomandohet për atë rrugë.



2128. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim tejkalimi për të gjitha automjetet, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore.
- Lejon tejkalimin e automjeteve.
- Ndalim trafiku për automjete.



2129. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim tejkalimi për të gjitha automjetet, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore.
- Përballëkalimin.
- Ndalini e tejkalimit për mjetet transportuese-kamionë.



2130. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kalimi pa u ndalur-dogana.
- Kalimi pa u ndalur-pagesa rrugore.
- Kalimi pa u ndalur-policia.



2131. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kalimi pa u ndalur-dogana.
- Kalimi pa u ndalur-pagesa rrugore.
- Kalimi pa u ndalur-policia.



2132. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kahe të detyrueshme.
- Anashkalime te obliguara.
- Rrugën ku trafiku zhvillohet në një kah.



2133. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Pjesën e rrugës ku lejohet përdorimi i shenjave akustike.
- Pjesën e rrugës ku ndalohet parkimi i mjeteve.
- Ndalon dhënien e shenjave akustike-zërit.



2134. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Përparësi kalimi për mjetet nga kahu i kundërt.
- Përparësi kalimi në raport me mjetet nga kahu i kundërt.
- Ndalim trafiku në këtë rrugë.



2135. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim ndaljeje dhe parkimi.
- Zonën e parkimit.
- Ndalon vetëm parkimin.



2136. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalon ndaljen dhe parkimin.
- Zonën e parkimit.
- Ndalon vetëm parkimin.



2137. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalim ndaljen dhe parkimin në ditët çift.
- Ndalim ndaljen dhe parkimin në ditët tek.
- Ndalim parkimi në ditët tek.



2138. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Ndalon ndaljen dhe parkimin në ditët çift.
- Ndalon ndaljen dhe parkimin në ditët tek.
- Ndalim parkimi në ditët çift.



2139. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Përdorimin e radarit.
- Ndalimin e shenjave akustike.
- Ndalimin e fotografimit.



2140. Çka na tregon kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Shpejtësinë më të vogël të lejuar.
- Të urdhrave të prera.
- Rekomandim të shpejtësisë.



2141. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Pajisjet dimërore obligative.
- Goma rezervë obligative.
- Pajisjet rezervë obligative.



2142. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për biçiklistë.
- Vendkalimin për biçiklistë.
- Ndalim trafiku për biçiklistë.



2143. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për këmbësorë.
- Vendkalimin e shënuar për këmbësorë.
- Ndalim trafiku për këmbësorë.



2144. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për këmbësorë dhe biçikleta.
- Vendkalimin e shënuar për këmbësorë dhe biçikleta.
- Ndalim trafiku për këmbësorë.



2145. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për kalorës.
- Vendkalimin për kalorës.
- Ndalimin e lëvizjes për kalorës.



2146. Çka tregon kjo shenjë e trafikut ?

- Rrugë me një kah.
- Drejtimin e obliguar.
- Anashkalimin e obliguar djathtas.



2147. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Rrugë me një kah.
- Drejtimin e obliguar djathtas.
- Ndalim trafiku në këtë rrugë.



2148. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Rrugën me një kah.
- Drejtimin e obliguar majtas.
- Ndalimin e trafikut në këtë rrugë.



2149. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Drejtim i obliguar.
 Anashkalimin në rrugë.
 Rrugë me një kah.



2150. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Drejtim i obliguar.
 Anashkalimin në rrugë.
 Rrugë me një kah.



2151. Në cilat drejtime ju lejohe të lëvizni sipas shenjës në foto?

- Drejt.
 Majtas.
 Djathtas.



2152. Si do të veproni nëse hasni në këtë shenjë të trafikut?

- Më lejohe të lëvizja vetëm djathtas.
 Më lejohe të lëvizja drejt ose djathtas.
 Më lejohe të lëvizja majtas.



2153. Si do të veproni nëse hasni në këtë shenjë të trafikut?

- Do të vazhdoj lëvizjen drejt.
 Duhet të vazhdoj lëvizjen majtas ose djathtas.
 Duhet të vazhdoj lëvizjen vetëm majtas.



2154. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Anashkalimin e obliguar djathtas.
 Anashkalimin e obliguar majtas.
 Drejtimin e obliguar djathtas.



2155. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Anashkalim i obliguar djathtas.
 Anashkalim i obliguar majtas.
 Drejtimin e obliguar djathtas.



2156. Çka tregon kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Kryqëzimin me rrethrotullim.
 Të urdhreve të prera.
 Afërsinë e kryqëzimit me rrethrotullim.



2201. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Kufizimin e shpejtësisë maksimale në Republikën e Kosovës.
- Kufizimin e shpejtësisë sipas llojit të rrugëve.
- Obligimin e ndezjes së dritave të shkurtëra kur mjete merr pjesë në trafik.



2202. Çka tregon kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Shtegun për këmbësorë.
- Vendkalimin e shënuar për këmbësorë.
- Të urdhrave të prera.



2203. Çka tregon kjo shenjë e trafikut?

- Shtegun për biçiklistë.
- Vendkalimin për biçiklistë.
- Ndalimin e lëvizjes për biçiklistë.



2204. Çka na tregon kjo shenjë e trafikut?

- Vandin e rrugës në të cilën fëmijët lëvizin shpesh ose në numër të madh.
- Shtegun për këmbësorë.
- Vendkalimin e shënuar për këmbësorë.



2205. Çka na tregon kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Nënkalimin ose mbikalimin për këmbësorë.
- Të ndalimit.
- Të lajmërimit.



2206. Çka na tregon kjo shenjë e trafikut?

- Rrugën me trafik në një kah.
- Rrugën me trafik në dy kahe.
- Ndalim trafiku në këtë rrugë.




2207. Çka na tregon kjo shenjë e trafikut?

- Rrugën me trafik në një kah.
- Rrugën me trafik në dy kahe.
- Ndalim trafiku në këtë rrugë.



2208. Çka paraqet kjo shenjë e trafikut dhe në cilin grup të shenjave bën pjesë?

- Të obligimit.
- Rrugën me përparësi kalimi.
- Të lajmërimit.



2209. Çka tregon kjo shenjë e trafikutt?

- Rrugën me përparësi kalimi.
 Mbarimin e rrugës me përparësi kalimi.
 Ndalje të detyrueshme.



2210. Në cilin grup të shenjave bën pjesë kjo shenjë e trafikutt?

3156. **Në kryqëzim jeni duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi. Në cilat raste nuk ju lejohe të hyni në kryqëzim?**

- Nëse në semafor është e ndezur drita e gjelbër.
- Nëse polici më ka dhënë shenjën për ndalje.
- Nëse ka ngecur (bllokuar) trafiku në kryqëzim.

3157. **Para kryqëzimit është vendosur shenja “STOP”. Çka duhet të keni parasysh?**

- Ndalje e obligueshme para se të kaloj kryqëzimin.
- Duhet të ndalem sipas nevojës para shenjës.
- Duhet t'i jap përparësi kalimi rrugës tërthore.

3158. **Si duhet vepruar shoferi i mjetit i cili në kryqëzim kthehet majtas?**

- Duhet t'i lëshojë mjetet që vijnë nga kahu i kundërt dhe kthehen djathtas.
- Duhet t'i lëshojë mjetet që vijnë nga kahu i kundërt dhe lëvizin drejt.
- Ta japë treguesin e majtë të drejtimit.

3159. **Para kryqëzimit është vendosur shenja “Kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi”. Çka duhet të keni parasysh?**

- Duhet të ndalem çdo herë para shenjës.
- Duhet t'i jap përparësi kalimi mjeteve që lëvizin në rrugën tërthore.
- Duhet të ndalem sipas nevojës.

3160. **Çka duhet të keni parasysh nëse kryqëzimi është i rregulluar me shenja trafikut?**

- Çdo herë duhet të ndalem para kryqëzimit.
- Do ta respektoj domethënien e shenjës së trafikut.
- Respektimin e rregullës së krahut të djathtë.

3161. Çka ia mundëson shoferit përcjelljen e kushteve të trafikut në kryqëzim?

- Qartësia e të pamurit.
- Dallimi i ngjyrave.
- Fusha e gjerë e dukshmërisë.

3162. Si duhet vepruar shoferi i mjetit i cili i afrohet kryqëzimit?

- Të lëvizë me kujdes të shtuar.
- Të vërtetojë mënyrën e rregullimit të përparësisë së kalimit.
- Duhet të lëvizë me shpejtësi maksimale që zhvillon automjeti.

3163. Në cilat kryqëzime vlejné rregullat e krahut të djathtë ?

- Në kryqëzime të rregulluara me shenja të trafikut.
- Në kryqëzim të rrugëve me rendësi të njëjtë.
- Vetëm në kryqëzime të rregulluar me semafor.

3164. Cilat shenja të trafikut e rregullojnë përparësnë e kalimit në kryqëzim?

- Shenja "Ndalje e obligueshme"
- Shenja "Rruga me një kah".
- Shenja "Trafiku zhvillohet në dy kahe".

3165. Çka duhet pasur parasysh kur i afroheni një kryqëzimi me rrethrotullim me shumë shirita të trafikut?

- Do të rreshtohem sipas shenjave në rrugë.
- Për daljen e parë do të rreshtohem në shiritin e djathtë të skajshëm.
- Do të vërtetoj si është rregulluar përparësia e kalimit në kryqëzim.

3166. Si duhet vepruar shoferi i mjetit i cili në kryqëzim kthehet majtas?

- Duhet t'i lëshojë mjetet që vijnë nga kahu i kundërt dhe kthehen djathtas.
- Duhet t'i lëshojë mjetet që vijnë nga kahu i kundërt dhe lëvizin drejt.
- Duhet t'i lëshojë vetëm mjetet që lëvizin drejt.

3167. Çka duhet të ketë parasysh shoferi i automjetit i cili hyn nga rruga dytësore në rrugën kryesore?

- Duhet tu japë përparësi mjeteve të cilat lëvizin në rrugën kryesore.
- Duhet respektuar shenjën e trafikut.
- Të respektojë rregullën e krahut të djathtë.

3168. Në cilat raste nuk duhet të ndaleni para shenjës STOP?

- Nëse në semafor është e ndezur drita e gjelbër.
- Nëse polici ka dhënë shenjën për kalim të lirë.
- Nëse nuk ka pjesëmarrës tjerë në rrugë.

3169. **Si njoftoheni që jeni duke lëvizur në rrugën kryesore?**

- Në bazë të shenjës së trafikut.
- Në bazë të shiritave të trafikut.
- Në bazë të numrit të mjeteve që lëvizin.

3170. **Si njoftoheni që jeni duke lëvizur në rrugën dytësore?**

- Në bazë të shenjës “Ndalje e obligueshme” .
- Në bazë të shenjës “ Kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi”.
- Në bazë të gjerësisë së rrugës.

3171. **Si mund të jetë e rregulluar përparësia e kalimi në kryqëzim?**

- Me person të autorizuar.
- Me semafor.
- Me rregullën e krahut të djathtë.

3172. **Si duhet vepruar shoferi i cili i afrohet kryqëzimit?**

- Të lëvizë me atë shpejtësi që mund të ndalet e t'i lëshojë mjetet që kanë përparësi kalimi.
- Të vërtetojë mënyrën e rregullimit të përparësisë së kalimit.
- Të rreshtohet me kohë në shiritin nëpër të cilin do të lëshojë kryqëzimin.

3173. **Si bëhet kthimi djathtas në kryqëzim, nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe?**

- Në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut.
- Nga shiriti i mesëm i rrugës.
- Nga cilido shirit në kahun e lëvizjes.

3174. **A i lejohet shoferit të hyjë në kryqëzim në rast se dendësia është e tillë që ai me mjet do të ndalej në kryqëzim?**

- Jo, edhe në rast se ai lëviz në rrugën me përparësi kalimi.
- Jo, edhe në rast se në semafor është e ndezur drita e gjelbër.
- Po nëse pengohen mjetet që lëvizin prapa.

3175. **Çka nuk i lejohet këmbësorit në rrugë?**

- Lojërat dhe lëvizja me pajisje të ndryshme.
- Qëndrimi ulur apo shtrirë në trotuar.
- Lëvizja në shtegun e përbashkët për biçikleta dhe këmbësorë.

3176. **Cilat rregullat vlejné për këmbësorë gjatë lëvizjes jashtë zonës urbane?**

- Duhet ta shfrytëzojë anën e majtë të rrugës në kah të lëvizjes.
- Gjatë kohës së pashmërisë së zvogëluar ta mbajë ndonjë mjet ose pajisje reflektuese apo burim drite.
- Duhet të jetë çdo herë nën përcjelljen e personit të moshës madhore.

3177. **Çka nuk i lejohet këmbësorit?**

- Lëvizja në rrugë.
- Qendrimi në rrugë.
- Ecja natën pa ndonjë burim drite jashtë zonës urbane.

3178. **Cilët janë pjesëmarrësit më të rrezikuar në trafikun rrugor?**

- Fëmijët.
- Personat e verbër.
- Personat me aftësi të kufizuar.

3179. **A i lejohet këmbësorit të kalojë rrugën jashtë vendkalimit të këmbësorëve?**

- Po, çdo herë.
- Po, nëse vendkalimi është më larg se 100 m nga vendi ku do të kalojë rrugën jashtë zonës urbane.
- Jo, në asnjë rast.

3180. **Çka nuk i lejohet këmbësorit?**

- Kalimi i rrugës ku fushëpamja e rrugës është e kufizuar.
- Kalimi i rrugës me dëgjojse (kufje) në vesh, duke përfshirë edhe vendkalimin e shënuar për këmbësorë.
- Ecja përgjatë vijës hekurudhore.

3181. **Çka nuk i lejohet këmbësorit në rrugë?**

- Lëvizja ose qëndrimi në rrugë.
- Kalimi i rrugës nëse vendkalimi është më afër se 50 m nga vendi ku do të kalojë rrugën, brenda zonës urbane.
- Hyrja në rrugë prapa mjetit që kufizon fushëpamjen e rrugës.

3182. **Si reagojnë fëmijët në rrugë?**

- Në të shumtën e rasteve nuk janë të vetëdijshëm për rrezikun në trafik.
- Pa parashikim dhe spontanisht.
- Çdo herë në pajtim me rregullat e trafikut.

3183. **Çka duhet të mbajë si shenjë identifikimi personi i verbër kur merr pjesë në trafik pa praninë e personit përcjellës?**

- Shkopin e bardhë.
- Një shenjë dalluese, ose të jetë nën përcjellje e qenit të aftësuar për udhëheqje.
- Këpucë të bardha.

3184. **Si do të veproni kur personi i verbër e kalon rrugën?**

- Do ta rris kujdesin.
- Do të ndalem dhe do t'i mundësoj kalimin e rrugës.
- Do t'ia tërheq vërejtjen me shenja akustike.

3185. **Çka konsiderohet hyrje në trafik?**

- Kur hyn në rrugë nga prona ose nga një rrugë dheu.
- Kur hyn në rrugë nga rruga në të cilën nuk zhvillohet trafik publik.
- Ngasja nëpër kthesa.

3186. **Cilat janë detyrimet e shoferit para se të ndërmarrë ndonjë veprim?**

- Duhet t'i paralajmërojë qartë dhe me kohë pjesëmarrësit e tjerë në trafik për qëllimin e tij.
- Nëse nuk ekzistojnë treguesit e drejtimit, veprimin duhet paralajmëruar duke dhënë shenjë përkatëse me dorë.
- Të shikojë vetëm këndin e vdekur.

3187. **Cilat kushtet duhet plotësuar nëse me mjet transportohen fëmijë në mënyrë të organizuar ?**

- Mjeti duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta dhe të jetë i shënuar me shenjë të veçantë,
- Gjatë kohës së hyrjes dhe daljes së fëmijëve nga mjeti, shoferi duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit të mjetit.
- Mjeti duhet të jetë i shënuar me trekëndësh të sigurisë.

3188. **Si duhet ta ngasë mjetin shoferi në rrugë publike?**

- Në anën e djathtë të kahut të lëvizjes së rrugës.
- Në shiritin e trafikut të caktuar për lëvizjen e atij lloji të mjeteve të cilit i takon mjeti.
- Nëse shiritat janë të shënuar, nëpër mesin e shiritit të trafikut.

3189. **Si duhet ta ngasë mjetin shoferi në rrugë publike?**

- Në anën e majtë të lëvizjes së rrugës.
- Në shiritin e trafikut të caktuar për lëvizjen e atij lloji të mjeteve të cilit i takon mjeti.
- Në çdo rrugë të pashënuar me vija ndarëse, ta drejtojë mjetin sa më afër skajit të djathtë të rrugës.

3190. **Cilat janë kufizimet për shoferët e rinj gjatë dy viteve të para të posedimit të patentë shoferit?**

- Nuk u lejohe të lëvizin me shpejtësi më të madhe se 50 km/h në rrugët nacionale.
- Nuk u lejohe ta kryejnë transportin e organizuar të fëmijëve.
- Ngasja e automjetit pa qenë i shënuar me tabelë përkatëse.

3191. **Cilat janë kufizimet për shoferët e rinj gjatë dy viteve të para të posedimit të patentë shoferit?**

- Nuk u lejohe të lëvizin me shpejtësi më të madhe ose 70 km/h në rrugët nacionale.
- Nuk u lejohe ta kryejnë transportin e organizuar të fëmijëve.
- Nuk u lejohe fare përdorimi i alkoolit para dhe gjatë ngasjes .

3192. **Cilat janë kufizimet për shoferët e rinj gjatë dy viteve të para të posedimit të patentë shoferit?**

- Nuk u lejohe të lëvizin me shpejtësi më të madhe se 110 km/h në autoudhë.
- Nuk u lejohe ta kryejnë transportin e organizuar të fëmijëve.
- Ngasja e automjetit pa qenë i shënuar me tabelë përkatëse.

3193. **Si duhet vepruar shoferi i mjetit kur tejkalohej nga mjete tjetër?**

- Të largojë mjetin kah skaji i djathtë i rrugës.
- Nuk i lejohej të rrisë shpejtësinë.
- Duhet të ndalet në vend.

3194. **Cilat mjete nuk lejohen të tejkalohej?**

- Vetëm mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme.
- Mjetet nën përcjellje kur janë në intervenim (detyrë).
- Mjetet të cilat lëvizin në kolonë (Kolonën e mjeteve).

3195. **A lejohet të tejkalohej mjete në kryqëzim i cili ka sinjalizuar për kthim djathtas?**

- Po, vetëm në kryqëzim të rregulluar me person të autorizuar.
- Po, nëse gjatë tejkalimit nuk kalohet në shiritin rrugor për mjetet që lëvizin nga kahu i kundërt .
- Jo, në asnjë rast.

3196. **Si duhet vepruar shoferi i cili synon që me mjet të fillojë tejkalimin?**

- Të shikojë në pasqyrën e brendshme, të jashtme, dhe në këndin e vdekur.
- Duhet të sinjalizojë me treguesin e drejtimit.
- Të vështrojë trafikun nga prapa.

3197. **A duhet të sinjalizojë shoferi pas tejkalimit gjatë kthimit në shiritin në të cilin ka lëvizur para tejkalimit?**

- Po, parashihet me rregulla të trafikut.
- Jo, vetëm në raste të veçanta.
- Po, vetëm jashtë zones urbane.

3198. **Nga cila anë tejkalohej tramvaji i cili lëviz në mes të rrugës me një kah?**

- Nga ana e djathtë.
- Nga ana e majtë.
- Vetëm nga ana e djathtë.

3199. **Nga çka varet gjatësia e rrugës së tejkalimit?**

- Nga shpejtësia e mjetit i cili tejkalohej.
- Nga shpejtësia e mjetit i cili tejkalon.
- Nga tipi i mjetit i cili tejkalohej.

3200. **Ku është i ndaluar tejkalimi?**

- Aty ku ndalohet me shenja në rrugë (horizontale).
- Aty ku ndalohet me rregulla të trafikut.
- Në vendkalimin e biçiklistëve.

3201. **A lejohet tejkalimi, në kryqëzim me rrethrotullim?**

- Po, parashihet me rregullat e trafikut.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, vetëm motoçikletat pa rimorkio anësore.

3202. **Në cilat vende është i ndaluar tejkalimi?**

- Në vendkalimin e biçiklistëve.
- Aty ku ndalohet me shenjë të trafikut.
- Në të gjitha kryqëzimet.

3203. **Si duhet vepruar shoferi i cili tejkalohe?**

- Nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes në kohën derisa tejkalohe.
- Duhet ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes.
- Në rast rreziku të drejtpërdrejtë duhet ta zvogëlojë shpejtësinë e lëvizjes.

3204. **A lejohet tejkalimi i mjeteve drejtpërdrejt para dhe në kryqëzim?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, në kryqëzim me rrethrotullim.
- Po, në të gjitha kryqëzimet.

3205. **Nga cila anë tejkalohe tramvaji i cili lëvizë në mes të rrugës me dy kahe?**

- Nga ana e majtë.
- Nga ana e djathtë.
- Varësisht nga dendësia e trafikut .

3206. **Kur nuk i lejohet shoferit të fillojë tejkalimin e mjetit?**

- Nëse shiriti nëpër të cilin mendon ta bëjë tejkalimin nuk është i lirë.
- Nëse është i ndaluar me shenjë të trafikut.
- Nëse pas tejkalimi nuk mund të kthehet përsëri me mjet në shiritin që ka lëvizur para tejkalimit.

3207. **A lejohet tejkalimi i kolonës së mjeteve?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse kolona lëviz ngadal.
- Po, në rrugë jashtë zonës urbane.

3208. **Ku është i ndaluar tejkalimi?**

- Aty ku ndalohet me shenja në rrugë (horizontale).
- Aty ku ndalohet me rregulla të trafikut.
- Në rrugë ku trafiku zhvillohet në një kah.

3209. Në cilat raste ndalohet tejkalimi?

- Drejtpërdrejt para dhe në vendkalimin e biçiklistëve.
- Në shiritin për nxitim.
- Nëse mjeteve është duke lëvizur në kah të njëjtë por është ndaluar që t'i lëshojë këmbësorët.

3210. A ju lejohe të tejkaloj mjetin tjetër drejtpërdrejt para dhe në kryqëzim?

- Po, mjetin që lëviz në rrugë me përparësi kalimi.
- Po, në kryqëzim me rrethrotullim.
- Jo, në asnjë rast.

3211. A ju lejohe të tejkaloj mjetin në pjesën e rrugës të kufizuar me vijë të plotë gjatësore?

- Po, mjetet të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi mbi 30 km/h.
- Po, mjetet të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi mbi 20 km/h.
- Jo, në asnjë rast.

3212. Cilin mjet nuk lejohe të tejkalohe?

- Mjetin i cili lëviz në kolonë (Kolonën e mjeteve).
- Mjetin i cili është ndaluar për të lëshuar këmbësorin.
- Mjetin nën përcjellje kur është në intervenim.

3213. A lejohe tejkalimi në afërsi të qafë së malit?

- Jo, nëse rruga ka vetëm një shirit të trafikut për një kah.
- Po, vetëm nëse nuk ka mjete tjera në rrugë.
- Po, nëse rruga ka së paku dy shirita të trafikut për një kah.

3214. A lejohe tejkalimi i traktorit në pjesën e rrugës së kufizuar me vijë të plotë gjatësore?

- Jo, pasi është e ndaluar me rregullat e trafikut.
- Po, nëse nuk pengohen ose rrezikohen pjesëmarrësit tjerë në trafik.
- Po, vetëm jashtë zonës urbane.

3215. Çka duhet të keni parasysh gjatë tejkalimit të mjeteve me dy rrota?

- Distanca anësore e sigurisë duhet të jetë së paku 1 m.
- Distanca anësore e sigurisë duhet të jetë së paku 1.5 m.
- Do të sinjalizoj me tregues të drejtimit.

3216. Në cilat kryqëzime lejohe tejkalimi?

- Në kryqëzim i cili rregullohet nga personi i autorizuar.
- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Në kryqëzim i cili rregullohet me semafor.

3217. **A ju lejohet tejkalmimi në kryqëzim, i cili është rregulluar me shenjë të trafikut?**

Po, nëse lëviz në rrugë me përparësi kalimi.

Jo, në asnjë rast.

Po, vetëm në rrugë me trafik në një kah.

3218. **Çka duhet të ketë parasysh shoferi para se të filloj tejkalmimin?**

Të sigurohet se tejkalmimin mund ta bëjë në mënyrë të sigurt.

T'i lajmërojë me kohë me shenjen përkatëse pjesëmarrësit tjerë të trafikut.

Që rruga të ketë hapsirë të mjaftueshme për ta kryer tejkalmimin.

3219. **Si do të veproni para se të filloni tejkalmimin?**

Të sigurohem se shoferi i mjetit para tij nuk e ka filluar tejkalmimin.

Të sigurohem që shiriti rrugor nëpër të cilin kam ndërmend ta bëj tejkalmimin, është i lirë.

Të sigurohem se me shenjë të trafikut nuk e kam të ndaluar tejkalmimin.

3220. **Cilat mjete lejohen të tejkaloen në kryqëzim të rrugëve me rëndësi të njëjtë?**

Të gjitha mjetet rrugore.

Biçikletat.

Motoçikletat pa rimorkio anësore.

3221. **Cilat drita përdoren natën gjatë tejkalmimit?**

Dritat e shkurtëra.

Pas mbarimit të tejkalmimit mund të përdoren dritat e gjata.

Dritat e gjata që të shihet rruga më mirë në distancë të mjaftueshme.

3222. **Cilat mjete lejohen të tejkaloen para dhe në kryqëzim të rrugëve me rëndësi të njëjtë?**

Biçikletat.

Traktorët.

Automjetet e udhëtarëve (veturat).

3223. **Cilat janë rreziqet e mundshme gjatë tejkalmimit?**

Kalohet në shiritin e trafikut të paraparë për mjetet që lëvizin nga kahu i kundërt.

Nënvlërësimi i shpejtësisë së mjetit, i cili vjen nga kahu i kundërt.

Shoferi i mjetit i cili tejkaloet mund ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes.

3224. **Çka duhet të keni parasysh gjatë kohës derisa ju tejkalon mjeti tjetër?**

Mjetin do ta largoj kah skaji i djathtë i rrugës.

Nuk më lejohet rritja e shpejtësisë.

Duhet të ndal mjetin në vend.

3225. **Cilat janë obligimet e shoferit para tejkalimit?**

- Të sigurohet se shoferi i mjetit që lëviz prapa tij nuk e ka filluar tejkalimin.
- Të sigurohet se shoferi para tij në të njëjtin shirit të trafikut nuk ka sinjalizuar që të tejkalojë ndonjë mjet tjetër.
- Rruga të ketë hapsirë të mjaftueshme që të kryhet tejkalimi.

3226. **A i lejohet shoferit të mjetit të rrisë shpejtësinë gjatë kohës derisa tejkalohe nga mjeti tjetër?**

- Po, nëse është duke lëvizur ngadal.
- Jo, nuk lejohet me rregullat e trafikut.
- Po, në rrugë jashtë zonave urbane.

3227. **Cilat janë obligimet e shoferit para dhe gjatë tejkalimit?**

- Të vështrohet trafiku nga prapa.
- Të sigurohet mos po i vjen ndonjë mjet nga kahu i kundërt.
- Ta mbaj distancën anësore të sigurisë.

3228. **Ku ndalohet tejkalimi?**

- Aty ku ndalohet me rregulla të trafikut.
- Në kryqëzim me rrethrotullim.
- Në kryqëzim me rëndësi të njëjtë, përveç mjeteve me dy rrota pa rimorkio anësore.

3229. **Si është i rregulluar anashkalimi?**

- Me rregullat e trafikut.
- Vetëm me person të autorizuar.
- Me shenjë të trafikut .

3230. **Cilat rreziqe mund të paraqiten gjatë anashkalimit?**

- Mund të vijë mjeti nga kahu i kundërt.
- Hapja e befasishme e dyerve të mjetit, i cili është i ndalur ose i parkuar.
- Nëse nuk ndezen të gjithë treguesit e drejtimit gjatë anashkalimit.

3231. **Nga cila anë mund ta anashkalojë shoferi ishullin për këmbësorë i cili gjendet në mes të rrugës me një kah?**

- Nga ana e djathtë.
- Nga ana e majtë.
- Vetëm nga ana e mjetit.

3232. **Cilat janë obligimet e shoferit para dhe gjatë anashkalimit?**

- Të ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.
- Të sigurohet mos po vjen ndonjë mjet nga kahu i kundërt.
- Ta mbajë distancën anësore të sigurisë.

3233. **Si është i rregulluar përballëkalimi?**

- Me shenja të trafikut.
 Me rregulla të trafikut.
 Vetëm me semafor.

3234. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilin përballëkalimi është i vështirësuar, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin?**

- Mjeti i lehtë i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë (rëndë).
 Kamioni, kur takohet me automjetin e udhëtarëve (veturën).
 Automjeti i udhëtarëve, kur takohet me kamionin.

3235. **Kur mjetet vijnë në kryqëzim nga kahu i kundërt dhe kthehen majtas, nga cila anë përballëkalohen?**

- Nga ana e majtë e tyre.
 Nga ana e djathtë e tyre.
 Nga cilado anë.

3236. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilin përballëkalimi është i vështirësuar, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin?**

- Automjeti i udhëtarëve (vetura), kur takohet me bashkësinë e mjeteve.
 Automjeti i udhëtarëve, i cili tërheq kampshtëpizen kur takohet me autobusin.
 Automjeti i udhëtarëve, kur takohet me kamionin.

3237. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilin përballëkalimi është i vështirësuar, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin?**

- Mjeti i lehtë, i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë (rëndë).
 Kamioni, ku takohet me automjetin e udhëtarëve (veturën) e cila tërheq kampshtëpizen.
 Kamion, ku takohet me automjetin e udhëtarëve.

3238. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilin përballëkalimi është i vështirësuar, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin? .**

- Mjeti i lehtë, i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë (rëndë).
 Kamioni, kur takohet me automjetin e udhëtarëve (veturën) e cila tërheq kampshtëpizen.
 Automjeti i udhëtarëve, kur takohet me kamionin.

3239. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore takohen mjetet e kategorisë së njëjtë, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin?**

- Mjeti i cili lëvizë teposhtëze.
 Mjeti i cili lëvizë përjetëze.
 Mjeti i cili lëviz më shpejt.

3240. **Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilin përballëkalimi është i vështirësuar, cili mjet duhet të lëvizë prapa për ta mundësuar përballëkalimin?**

- Mjeti i rëndë, i cili takohet me mjetin e kategorisë së lehtë.
 Kamioni, kur takohet me automjetin e udhëtarëve (veturën) e cila tërheq kampshtëpizen.
 Automjeti i udhëtarëve, kur takohet me kamionin.

3241. Sa është shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonës urbane nëse me shenjë trafiku nuk është përcaktuar ndryshe?

50 km/h

60 km/h.

80 km/h.

3242. Sa është shpejtësia më e madhe e lejuar në rrugë nacionale?

70 km/h.

110 km/h, në rrugë me dy ose më tepër shirita të trafikut për një kahe me ndarje fizike.

80 km/h, në rrugë me një shirit trafikut për një kahe.

3243. Sa është shpejtësia më e madhe e lejuar në motoudhë?

80 km/h

100 km/h.

110 km/h.

3244. Sa është shpejtësia më e madhe e lejuar në rrugë nacionale?

70 km/h, në rrugë me një shirit trafikut për një kahe.

100 km/h, në rrugë me dy ose më tepër shirita të trafikut për një kahe me ndarje fizike.

110 km/h, në rrugë me dy ose ma tepër shirita trafikut për një kahe me ndarje fizike.

3245. Cilat shpejtësi vlejné në autoudhë?

Shpejtësia më e madhe e lejuar deri 130 km/h.

Shpejtësia më e madhe e lejuar deri 110 km/h.

Shpejtësia më e vogël e lejuar së paku 60 km/h.

3246. Cilat janë denimet nëse shoferi e tejkalon shpejtësinë mbi 30km/h deri 50 km/h brenda zonës urbane?

Shqiptimi i tri pikëve negative.

Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje deri në 3 muaj.

Dënimi me të holla prej 200 deri 600 euro.

3247. Cilat shpejtësi vlejné në motoudhë?

Shpejtësia më e madhe e lejuar deri 130 km/h.

Shpejtësia më e madhe e lejuar deri 110 km/h.

Shpejtësia më e vogël e lejuar së paku 60 km/h.

3248. Për cilat rrugë vlejné kufizimi i shpejtësia 80 km/h nëse me shenjë të trafikut nuk është përcaktuar ndryshe?

Në rrugët rajonale.

Në rrugë lokale.

Në të gjitha rrugët brenda zonës urbane.

3249. **A lejohet shpejtësia më e madhe se 50 km/h brenda zonës urbane?**

- Jo, në asnjë rast .
- Po, me shenjë të trafikut deri 80 km/h.
- Po, me shenjë të trafikut vetëm deri 60 km/h.

3250. **Për cilat mjete vlenë kufizimi i shpejtësisë maksimale 40 km/h?**

- Për mjetin i cili terheq mjetin tjetër në defekt.
- Për traktor klasik.
- Për mjetin e udhëtarëve (veturën) e cila terheq kamp-shtëpizën.

3251. **Për cilat mjete vlenë kufizimi i shpejtësisë maksimale 80 km/h?**

- Për mjetin i cili transporton persona në mënyrë grupore.
- Për mjetin i cili transporton materie të rrezikshme.
- Për mjetin e udhëtarëve (veturën) e cila tërheq kamp-shtëpizën.

3252. **Cilat janë dënimet nëse shoferi e tejkalon shpejtësinë mbi 30km/h deri 50 km/h jashtë zones urbane?**

- Shqiptimi i dy pikëve negative.
- Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri një vit.
- Dënimi me të holla prej 100 deri 300 euro.

3253. **Si përcaktohet shpejtësia e lëvizjes?**

- Me shenja të trafikut.
- Me rregulla të trafikut.
- Vetëm me shenja të trafikut.

3254. **Kur shoferi duhet ta zvoglojë shpejtësinë e lëvizjes?**

- Kur i afrohet vendndaljeve për autobus (kur autobusi është i ndalur).
- Kur kalon nga pjesa e ndriçuar në pjesën e pandriçuar të rrugës.
- Kur i afrohet kryqëzimit.

3255. **Si duhet përshtatur shpejtësinë e lëvizjes?**

- Sipas dukshmërisë së rrugës.
- Sipas kushteve të trafikut.
- Sipas kushteve të rrugës.

3256. **Cilat janë dënimet nëse shoferi e tejkalon shpejtësinë më tepër se 50km/h jashtë zones urbane?**

- Shqiptimi i tri pikëve negative
- Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje prej tre muajsh.
- Dënimi me të holla prej 200 deri 600 euro.

3257. **Cilat janë dënimet nëse shoferi e tejkalon shpejtësinë mbi 30km/h deri 50 km/h brenda zones urbane?**

- Shqiptimi i tri pikëve negative.
- Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj.
- Dënimi me të holla prej 200 deri 600 euro.

3258. **Si duhet përshtatur shpejtësinë brenda zonës urbane?**

- Sipas rregullave të trafikut që vlejën brenda zonës urbane.
- Sipas shenjave të trafikut.
- Sipas kushteve dhe rrethanave të përgjithëshme në rrugë.

3259. **Si duhet përshtatur shpejtësinë e lëvizjes?**

- Dukshmërisë (pamjes) së rrugës.
- Ngarkesës së mjetit.
- Aftësi personale të shoferit.

3260. **Cilat janë dënimet nëse shoferi e tejkalon shpejtësinë mbi 50km/h brenda zonës urbane?**

- Shqiptimi i pesë pikëve negative
- Masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri në një vjet.
- Dënimi me të holla prej 300 deri 900 euro.

3261. **Kur shoferi posaçërisht duhet ta zvogëlë shpejtësinë?**

- Nëse ka hasur në trekëndëshin e sigurisë i cili është i vendosur në rrugë.
- Kur i afrohet vendkalimit hekurudhor.
- Nëse në rrugë ka fëmijë.

3262. **Kur shoferi posaçërisht duhet ta zvogëlë shpejtësinë?**

- Kur i takon ose i hasë mjetet me përparësi kalimi.
- Gjatë përballëkalimit natën, kur mjete nga kahu i kundërt i ka të ndezura dritat e gjata.
- Gjatë tejkalimit.

3263. **Pse nuk i lejohet shoferit ngasja me shpejtësi shumë të vogël se sa parashihet me shenjë të trafikut?**

- Pa nevojë pengohet rrjedha e trafikut.
- Mundet të vijë deri te përpalsja e mjetit prapa me ate përpara.
- Nxiti shoferët të hyjnë në tejkalime të rrezikshme.

3264. **Ku duhet ta zvogëloni shpejtësinë e lëvizjes?**

- Në pjesën e rrugës ku paralajmërohet për shembje gurësh.
- Në pjesën e rrugës kur paralajmërohet ngushtim rruge nga të dy anët.
- Në shiritin për nxitim.

3265. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në nënkalime.
- Mbi rrjetin e kanalizimit.
- Brenda zonës urbane.

3266. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në tunel.
- Në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga garazhi.
- Mbi urë.

3267. **Ku ndalohet parkimi i mjetit ?**

- Në hyrje të rrugëve nëpër lagje.
- Në vendin ku mbulohet shenja e trafikut.
- Në vendndalje të autobusëve.

3268. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në distancë më të vogël se 5 metra para vendkalimit të këmbësorëve.
- Në nënkalime dhe mbikalime.
- Mbi binaret e tramvajit.

3269. **Ku ndalohet parkimi i mjetit ?**

- Në vendndalje të autobusëve.
- Në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga garazhi.
- Në vendparkim.

3270. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në kryqëzim.
- Në shiritin për biçikleta.
- Në afërsi të qafëmalit (kurriz).

3271. **Ku është ndaluar parkimi i mjetit?**

- Në vendkalimin e këmbësorëve.
- Në mbikalime.
- Në distancë më të vogël se 15 m, para dhe prapa shenjës “vendndalje e autobusëve”.

3272. **Ku është i ndaluar ndalja e mjetit?**

- Në nën dhe mbikalime.
- Në afërsi të qafëmalit.
- Në largësi prej 15 m, nga vendkalimi hekurudhor.

3273. **Ku ndalohet parkimi i mjetit?**

- Në distancë më të vogël se 15 m nga tuneli.
- Në distancë më të vogël se 15 m, para dhe prapa shenjës “ vendndalje e autobusëve”.
- Mbi kapakët e rrjetit të kanalizimit.

3274. **Ku ndalohet parkimi i mjetit?**

- Në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga parkingu.
- Në distancë më të vogël se 15 m, para dhe prapa shenjës “ vendndalje e autobusëve”.
- Në kalimet ndërmjet ndërtesave, përkatësisht në hyrje apo në dalje të blloqeve të banesave.

3275. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Brenda zonës urbane.
- Në vendkalimin e këmbësorëve
- Në kthesa të padukshme.

3276. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në motoudhë.
- Në qafë të malit.
- Në rrugë brenda zonës urbane.

3277. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Në distancë më të vogël se 5 metra para vendkalimit të këmbësorëve.
- Mbi rrjetin e kanalizimit.
- Në distancë më të vogël se 15 metra para vendkalimit të këmbësorëve.

3278. **Ku ndalohet parkimi i mjetit?**

- Në vendparkim.
- Në vendndalje të autobusëve.
- Nëse mjeti i parkuar do të pamundësonte daljen apo hyrjen në vendparking.

3279. **Ku ndalohet parkimi i mjetit?**

- Para hyrjes në oborr të shtëpisë.
- Në vendndalje të autobusëve.
- Në vendkalimin për biçikleta.

3280. **Ku ndalohet parkimi i mjetit?**

- Mbi kapakët e rrjetit të ujësjellësit.
- Në rrugët jashtë vendparkimeve të cilat i lidhin hapësirat e parkimit me ndërtesat e banimit dhe me rrugë të tjera.
- Në sipërfaqe të zgjeruar jashtë shiritit të trafikut, të paraparë për mjetet e transportit publik.

3281. **Ku ndalohet parkimi i mjetit ?**

- Mbi kapakët e rrjetit të ujësjellësit.
- Në kryqëzim.
- Në hyrje të rrugëve nëpër lagje.

3282. **Ku ndalohet ndalja e mjetit?**

- Mbi ura.
- Në distancë më të vogël se 5 m para vendkalimit të këmbësorëve.
- Mbi kapakët e rrjetit të ujësjellësit

3283. **Si duhet vepruar kur mjeti parkohet në përpjetëze?**

- Rrotat e para kthehen kah mesi i rrugës.
- Ndërruesi i shpejtësisë vihet në pozicion për ngasje përpara.
- Aktivizohet freni i parkimit

3284. **Si duhet vepruar kur mjeti parkohet në teposhtëze?**

- Rrotat e para kthehen kah skaji i djathtë i rrugës.
- Ndërruesi i shpejtësisë vihet në pozicion për ngasje prapa.
- Aktivizohet freni i parkimit.

3285. **Si duhet vepruar kur mjeti parkohet në teposhtëze?**

- Rrotat e para kthehen kah skaji i djathtë i rrugës.
- Rrotat e para kthehen nga mesi i rrugës.
- Aktivizohet freni i parkimit.

3286. **Ku ndalohet ndalja?**

- Para garazhit.
- Në hyrje të rrugëve nëpër lagje.
- Në shiritin për biçikleta.

3287. **Si duhet vepruar kur mjeti parkohet në përpjetëze?**

- Rrotat e para kthehen kah skaji i djathtë i rrugës.
- Rrotat e para kthehen nga mesi i rrugës.
- Aktivizohet freni i parkimit.

3288. **Çka duhet të keni parasysh nëse e drejtoni traktorin?**

- Nëse traktori tërheq rimorkion mund të transportohen deri 3 persona të cilët punojnë në ngarkim-shkarkim të ngarkesës.
- Duhet ngarë në shiritin anësor në rrugët nacionale me dy ose më tepër shirita për një kah me ndarje fizike.
- Nuk më lejohet lëvizja në shiritin e majtë në rrugë brenda zonës urbane me dy ose më tepër shirita për një kah, përveç para kryqëzimit.

3289. **Çka duhet të keni parasysh nëse e drejtoni traktorin?**

- Në kufizim të shpejtësisë që vlenë për traktorin.
- Duhet ngarë në shiritin anësor në rrugët nacionale me dy ose më tepër shirita për një kah me ndarje fizike.
- Më lejohet të tërheq mjete dhe vegla të bashkëngjitura, të cilat janë të parapara t'i tërheq traktori.

3290. **Çka paralajmron drita e kuqe në vendkalimin hekurudhor?**

- Ardhjen e trenit.
- Lëshuarjen e barrierave (mbrojtëset) ose gjysmëbarrierave.
- Ndaljen e detyrueshme para vendkalimit hekurudhor.

3291. **Si do të veproni nëse gjysmëbarrierat kanë filluar të ngriten?**

- Duhet të ndalem para vendkalimit hekurudhor deri sa të përfundojë ngritja e gjysmëbarrierave.
- Duhet ta kaloj vendkalimin hekurudhor në pjesën e majtë të rrugës.
- Nëse nuk ka mjet nga kahu i kundërt e kaloj vendkalimin hekurudhor nga ana e majtë e rrugës.

3292. **Si është i rregulluar vendkalimi hekurudhor?**

- Me person të autorizuar.
- Me barriera (mbrojtëse) dhe gjysmëmbrojtëse.
- Me pajisje ndriçuese që paralajmëron ardhjen e trenit.

3293. **Në kohën kur i afroheni vendkalimit hekurudhor, fillojnë të lëshohen mbrojtëset. Si do të veproni në këtë rast?**

- Do të ndalem para vendkalimit hekurudhor.
- Nëse nuk shihet treni, do të kaloj sa më shpejtë nëpër vendkalim hekurudhor.
- Nëse nuk ka mjete nga kahu i kundërt me shpejtësi të rritur do të kaloj vendkalimin hekurudhor.

3294. **Si duhet të kaloni vendkalimin hekurudhor pa shenja të trafikut?**

- Duhet rritur shpejtësinë dhe sa më parë të kalohet vendkalimi hekurudhor.
- Duhet më parë të sigurohet se nuk ka tren, e pastaj me kujdes të shtuar të kalohet vendkalimi hekurudhor.
- Duhet me shpejtësi të njëjtë që të kalohet vendkalimi hekurudhor.

3295. **Kur mund ta kaloni vendkalimin hekurudhor pa mbrojtëse me dritë të kuqe, pasi që treni ka kaluar?**

- Atëherë kur drita e kuqe fiket.
- Pasi ka kaluar treni, do të kaloj pa u fikur drita e kuqe.
- Menjëherë si të fillojnë të lëvizin mjetet nga kahu i kundërt.

3296. **Në cilat raste jeni të detyruar të ndaleni para vendkalimit hekurudhor?**

- Nëse para vendkalimit hekurudhor është shenja “Ndalje e obligueshme”.
- Nëse barrierat kanë filluar të lëshohen.
- Nëse janë të ndezura dritat e kuqe.

3297. **Cilat veprime ndalohen në autoudhë?**

- Tejkalimi.
- Lëvizja në kahun e kundërt në të njëjtin shirit rrugor.
- Kthimi gjysmërrethor.

3298. **Si njoftoheni se jeni duke lëvizur nëpër autoudhë?**

- Në bazë të shiritave të trafikut.
- Në bazë të shenjës së trafikut.
- Në bazë të gjerësisë së rrugës.

3299. **Cilat mjete nuk lejohen të lëvizin në autoudhë?**

- Automjetet që nuk mund të zhvillojnë shpejtësi së paku 60 km/h.
- Biçikleta.
- Mopedët.

3300. **Cilat veprime nuk lejohen në autoudhë?**

- Ndalja në rast defekti në shiritin për ndalje emergjente.
- Ngasja në shiritin për ndalje emergjente.
- Lëvizja prapa.

3301. **Si duhet vepruar shoferi gjatë ngasjes nëpër autoudhë?**

- Duhet të shfrytëzojë shiritin e djathtë të skajshëm për ngasje nëse nuk është i zënë në kolonë.
- Ta mbajë distancën e sigurisë ndaj mjetit që lëvizë përpara.
- Gjatë gjithë kohës ta shfrytëzojë shiritin e majtë të skajshëm për lëvizje.

3302. **Si do të veproni gjatë hyrjes në autoudhë?**

- Duhet ta shfrytëzojë shiritin për nxitim.
- Duhet t'u jap përparësi kalimi automjeteve të cilat lëvizin nëpër autoudhë.
- Duhet të ndalem çdo herë para hyrjes nëpër autoudhë.

3303. **Cilat veprime nuk lejohen në autoudhë?**

- Lëvizja me shpejtësi më të madhe se 130 km/h.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Lëvizja prapa.

3304 **Si do të veproni gjatë daljes nga autoudha?**

- Do të sinjalizoj me treguesin e djathtë të drejtimit.
- Do të kaloj në shiritin për ngadalsim.
- Sipas nevojës do të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes pasi të kaloj në shiritin për ngadalsim.

3305 . **Çka duhet të keni parasysh gjatë hyrjes në motoudhë?**

- Automjetet të cilat hyjnë në motoudhë kanë përparësi kalimi.
- Automjetet të cilat lëvizin në motoudhë kanë përparësi kalimi.
- Respektohet rregulla e krahut të djathtë gjatë hyrjes në motoudhë.

3306 . **Pas një kohe ngasjeje (udhëtimi) të gjatë, doni të dilni nga autoudha. Çka duhet pasur parasysh në këtë rast?**

- Do të kontrolloj shpejtësinë.
- Do të zvogloj shpejtësinë në shiritin për ngadalsim sipas nevojës.
- Daljen nga autoudha e sinjalizoj me treguesin e drejtimit.

3307. **Gjatë ngasjes në autoudhë keni kaluar gabimisht daljen e dëshiruar. Si do të veproni në këtë situatë?**

- Do t'i ndezi të gjithë treguesit e drejtimit dhe me ngasje prapa do të lëvizi deri te dalja më e afërt.
- Do të vazhdoj ngasjen deri te dalja tjetër.
- Do të bëj kthimin gjysmërrethor.

3308. **Cilat janë rreziqet e mundshme gjatë ngasjes në autoudhë?**

- Gjatë ndërrimit të shiritave për shkakë të mosshikimit në kënd të vdekur.
- Mosmbajtja e distancës së sigurisë.
- Lodhja dhe monotonia.

3309. **Nëse vjen deri te ngecja në autoudhë, si duhet të sillen shoferët e automjeteve në kolona?**

- Duhet skajuar djathtas dhe majtas, duke lënë mesin e lirë për mjetet me përparësi kalimi (intervenim).
- Mund të ngasin nëpër shiritin për ndalje emergjente deri te dalja e parë..
- Mund të bëjnë kthimin gjysmërrethor dhe të ngasin deri te dalja.

3310. **Cilat veprime ndalohen në autoudhë?**

- Shpejtësia më e madhe se 130 km/h.
- Shpejtësia më e vogël se 60 km/h.
- Tërheqja e mjetit në defekt natën.

3311. **Pse aksidentet zingjirorë janë më të shpeshta në autoudhë?**

- Për shkak të mosmbajtjes së distancës së sigurisë te shpejtësitë e mëdha.
- Frenimi i vullshëm.
- Moskujdesi.

3312. **Si do të ngitni nëpër autoudhë?**

- Do të ngas në shiritin e djathtë të skajshëm nëse nuk është i zënë në kolonë.
- Kohë pas kohe do të vështroj trafikun nga prapa.
- Me shpejtësi maksimale që zhvillon automjeti.

3313. **Cilat mjete nuk lejohen të lëvizin në motoudhë?**

- Mjetet që nuk mund të zhvillojnë shpejtësi së paku 60 km/h.
- Biçikletat.
- Motoçikletat.

3314. **Si njoftoheni se jeni duke lëvizur nëpër motoudhë?**

- Në bazë të shiritave të trafikut.
- Në bazë të shenjës së trafikut.
- Në bazë të gjerësisë së rrugës.

3315. **Cilat veprime ndalohen në motoudhë?**

- Lëvizja prapa.
- Tejkalimi.
- Kthimi gjysmërrethor.

3316. **Cilat veprime nuk lejohen në motoudhë?**

- Lëvizja me shpejtësi më vogël se 60 km/h.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Lëvizja prapa.

3317. **Si do të veproni gjatë daljes nga motoudha?**

- Duhet sinjalizuar me treguesin e drejtimit.
- Duhet vështruar trafikun nga prapa.
- Do të zvogëloj shpejtësinë sipas nevojës.

3318. **Si do të veproni gjatë hyrjes në motoudhë?**

- Do të hyj pa dhënë treguesin e drejtimit nëse nuk ka mjete prapa meje.
- Duhet t'u jap përparësi kalimi automjeteve të cilat lëvizin nëpër motoudhë.
- Duhet të ndalem çdo herë para hyrjes në motoudhë.

3319. **Cilat veprime nuk lejohen në motoudhë?**

- Lëvizja me shpejtësi më të vogël se 60 km/h.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Anashkalimi.

3320. **Si do të veproni gjatë ngasjes nëpër motoudhë?**

- Duhet kontrolluar trafikun nga prapa kohë pas kohe.
- Do ta mbajë distancën e sigurisë ndaj mjetit që lëviz përpara.
- Para çdo veprimi më parë do të sigurohem se nuk i pengoj dhe rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në trafik.

3321. **Cilat veprime nuk lejohen në tunel?**

- Ndalja dhe parkimi i mjetit.
- Përdorimi i dritave të shkurtëra.
- Kthimi gjysmërrethor.

3322. **Cilat janë rreziqet e mundshme gjatë ngasjes në tunel?**

- Mospërshtatja e shpejtësisë.
- Dobësimi (zvogëlimi) i dukshmërisë.
- Mosadaptimi i syve nga drita në errësi.

3323. **Cilat veprime nuk lejohen në tunel?**

- Lëvizja prapa.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Ndezja e dritave të shkurtëra.

3324. **Çka duhet të keni prasysh nëse keni hasur shenjën “Afërsia e tunelit”?**

- Do ta përshtati shpejtësinë e lëvizjes sipas nevojës do ta zvogëloj.
- Do t’i përdori dritat e shkurtëra për ndriçimin e rrugës.
- Nëse tuneli është i ndriçuar mirë, nuk kam nevojë t’i ndez dritat e shkurtëra.

3325. **Çka duhet të keni parasysh gjatë ngasjes nëpër tunel?**

- Në adaptim të syve nga drita në errësi.
- Në dobësim (zvogëlim) të dukshmërisë.
- Mund të hasni në ndonjë mjet të pandriçuar.

3326. **A lejohet lëvizja prapa në tunel?**

- Po, nëse tuneli është i ndriçuar.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse tuneli nuk është i gjatë.

3327. **A duhet ti përdorni dritat e shkurtëra në tunel gjatë ditës?**

- Po.
- Jo, nëse nuk ka trafik nga kahu i kundërt.
- Jo, në tunel me ndriçim.

3328. **Çka ndalohet në tunel?**

- Përdorimi i dritave të gjata.
- Kthimi gjysmërrethor.
- Lëvizja prapa.

3329. **Cilat rregullat nuk i zbatojnë mjetet nën përcjellje kur janë në intervenim?**

- Rregullat që kanë të bëjnë me kufizimin e shpejtësisë.
- Urdhrin e personit të autorizuar i cili rregullon trafikun rrugor.
- Tejkasimit.

3330. **Si duhet vepruar shoferi i mjetit i cili hasë mjetet nën përcjellje?**

- Duhet të ndalet.
- Duhet vepruar sipas urdhrin të personit të autorizuar.
- Duhet t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.

3331. **A i zbatojnë rregullat e trafikut mjetet nën përcjellje?**

- Jo, gjatë kohës kur janë në intervenim.
- Jo, në asnjë rast.
- Po çdo herë.

3332. **Cilat janë mjete me përparësi kalimi ?**

- Mjeti i zjarrfikësve, kur është në intervenim.
- Mjeti për mirëmbajtjen e rrugëve.
- Mjeti i policisë, kur është në intervenim.

3333. **Si duhet vepruar shoferi i mjetit i cili takon mjetin me përparësi kalimi?**

- Te ndalet sipas nevojës.
- Të veproj sipas urdhrave të personit të autorizuar.
- Natën t'i përdorë dritat e shkurtëra .

3334. **A iu lejohe mjetëve me përparësi kalimi kur janë në intervenim ta ndërpresin kolonën e këmbësorëve?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, parashihet me rregullat e trafikut.
- Po, vetëm në rrugë jashtë zonës urbane.

3335. **Kur konsiderohen se janë mjete me përparësi kalimi?**

- Nëse me pajisjet e veçanta japin sinjale me drita dhe zëri me intensitet të ndryshueshëm.
- Çdo herë kur marrim pjesë në trafik.
- Nëse me pajisjet e veçanta japin sinjale me drita dhe zëri me intensitet të pandryshueshëm.

3336. **A lejohe ngarkesa në mjet kalon pikën më të skajshme në anën e pasme më tepër se 1m?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, sipas rregullave të parapara.
- Po, vetëm deri 1 metër.

3337. **Sa mjete bashkangjitime mund të tërhiqen në rrugë nacionale?**

- Dy për transport të ngarkesës.
 Një për transport të personave.
 Varësisht nga fuqia e motorit.

3338. **A lejohet tërheqja e mjetit bashkangjites?**

- Jo, në asnjë rast.
 Po, nëse nuk zvogëlohet stabiliteti i tij.
 Po, nëse pajisjet sinjalizuese të mjetit bashkangjites janë në rregull.

3339. **Sa mjete bashkangjitime mund të tërhiqen në autoudhë?**

- Dy për transport të ngarkesës.
 Dy për transport të personave.
 Një për transport të ngarkesës.

3340. **Si duhet të vendoset ngarkesa në mjet?**

- Të mos ia zvogëlojë shoferit pamjen e rrugës.
 Të mos zvogëlojë stabilitetin e mjetit.
 Të mos e vështirësojë drejtimin e mjetit.

3341. **Deri në sa metra lejohet ngarkesa të kalojë pjesën e përparme të mjetit?**

- Deri 1m.
 Deri 1.5m.
 Deri 2 m.

3342. **Ngarkesa në mjetin e udhëtarëve (veturë) kalon pikën më të skajshme më tepër se 1m në anën e pasme. Si duhet të shënohet?**

- Me trekëndësh të sigurisë.
 Me pëlhurë të kuqe.
 Me tabelë 40 x50cm.

3343. **Si duhet të sistemohet ngarkesa në mjet?**

- Të mos krijojë zhurmë të tepërt.
 Të mos i mbulojë targat e regjistrimit.
 Të mos e dëmtojë rrugën.

3344. **A duhet të shënjëzohet ngarkesa gjatë transportit natën?**

- Jo, nëse nuk shkapërderdhet, ose nuk e dëmton rrugën.
 Po, sipas rregullave të parapara.
 Po, vetëm jashtë zonës urbane.

3345. **A lejohet tërheqja e automjetit?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse është në defekt.
- Po nëse ka mbetur pa karburant në rrugë.

3346. **Ku duhet të vendoset trekëndëshi i sigurisë gjatë tërheqjes së mjetit në defekt?**

- Në mjetin tërheqës.
- Në mjetin që tërhiqet.
- Vetëm në mjetin tërheqës.

3347. **A lejohet tërheqja e mjeteve me dy rrota?**

- Jo.
- Po nëse tërheqja bëhet në relacion të shkurtëra.
- Po, vetëm biçikletave.

3348. **Si mund të tërhiqet mjete i cili është në defekt?**

- Me litar.
- Me lidhje të ngurtë (big).
- Duke u mbështetur ose varur në mjetin tërheqës.

3349. **A lejohet tërheqja e mjetit me defekt natën?**

- Po, sipas rregullave të parapara.
- Jo, në asnjë rast.
- Po, vetëm në relacione të shkurtëra.

3350. **A lejohet tërheqja e mjetit defekt në autoudhë?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse defekti ka ndodhur gjatë ngasjes në autoudhë.
- Po deri te dalja e parë nga autoudha.

3351. **A lejohet tërheqja e bashkësisë së mjeteve të ngarkuara në defekt?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, deri te vendi i parë për ngarkim-shkarkim.
- Po, në raste të jashtëzakonshme, deri te vendi ku mund të mënjanohet defekti.

3352. **Cilat mjete në defekt nuk lejohen të tërhiqen në litar?**

- Nëse nuk funksionon sistemi i frenimit.
- Nëse nuk funksionon sistemi për drejtim.
- Nëse nuk funksionon pajisja për sinjalizim me zë (buria).

3353. **Si do të veproni nëse automjeti i juaj ka mbetur në defekt në autoudhë?**

- Do të vendosi trekëndëshin e sigurisë në distancë së paku 100 m pas automjetit.
- Do t'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.
- Do të ndez treguesin e djathtë të drejtimit.

3354. **Çka duhet të keni parasysh nëse gjatë ngasjes keni hasur në dy trekëndësha të sigurisë të vendosur në rrugë?**

- Në ndalje të mjetit në defekt që bartë materie të rrezikshme.
- Në ndalje të kolonës së mjeteve në defekt.
- Në ndalje të mjetit të udhëtarëve (veturës) në defekt.

3355. **Si duhet vepruar shoferi në rast të mjetit në defekt në rrugë nacionale?**

- Të vendosë trekëndëshin e sigurisë në distancë 30 deri 50m pas mjetit.
- T'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.
- Ta ndezë treguesin e djathtë të drejtimit.

3356. **Cili mjet në defekt nuk lejohet të tërhiqet me lidhje të fortë (bigë)?**

- Mjeti i cili e ka sistemin e drejtimit jashtë funksionit.
- Mjeti që amortizatorët nuk i ka në gjendje të rregullt.
- Mjeti i cili nuk i ka në rregull pajisjet paralajmëruese të zërit (buria).

3357. **Si duhet vepruar shoferi në rast të mjetit në defekt në autoudhë?**

- T'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.
- Mjetin ta ndalë në shiritn për ndalje emergjente.
- Të ndezë treguesin e majtë të drejtimit.

3358. **Si duhet vepruar shoferi i mjetit në defekt brenda zones urbane?**

- Të vendosë trekëndëshin e sigurisë në distancë pas mjetit prej së paku 10 metrash.
- T'i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit.
- Ta ndalë mjetin pranë skajit të djathtë të rrugës ose jashtë rrugës.

3359. **A lejohet tërheqja e mjetit në defekt ditën në rast të zvogëlimit (dobësimi) të dukshmërisë?**

- Jo, në asnjë rast.
- Po, sipas rregullave të parapara.
- Po, vetëm brenda zonës urbane.

3360. **A lejohet tërheqja e mjetit me defekt nëse sistemi i drejtimit nuk funksionon?**

- Po, nëse pajisjet për sinjalizim janë në rregull.
- Po, duke u mbështetur ose varur në mjetin tërheqës.
- Po, me lidhje të fortë (bigë).

3361. Cilët persona nuk lejohen të ulen në ulësen e përparme të mjetit të udhëtarëve (veturës)?

- Personat nën ndikimin e alkoolit.
- Fëmijët më të rinj se 12 vjeç.
- Personat e moshuar.

3362. Cilat veprime nuk iu lejohen udhëtarëve gjatë ngasjes?

- Të dalin me pjesë të trupit jashtë mjetit.
- Të ulen në dritare.
- Të komunikojnë ndërmjet vete.

3363. Cilët persona duhet të përdorin rripin e sigurisë?

- Shoferët.
- Personat të cilët janë të ulur në ulësen e përparme.
- Vetëm personat nën ndikimin e alkoolit.

3364. Kur duhet të përdoret rripi i sigurisë?

- Gjatë ngasjes brenda zonës urbane.
- Gjatë ngasjes jashtë zonës urbane.
- Vetëm nëse zhvillohet shpejtësia mbi 30 km/h.

3365. Cilët persona janë të liruar nga përdorimi i rripit të sigurisë?

- Të gjithë personat e moshuar.
- Gruaja shtatëzënë kur shtatëzania shihet.
- Nëse posedon certifikatë mjekësore me të cilën lirohet nga përdorimi i rripit.

3366. Cilët persona duhet të përdorin rripin e sigurisë në mjetin e udhëtarëve (veturë)?

- Personat në ulëset e përparme.
- Vetëm personat e moshës së mitur.
- Vetëm personat që janë nën ndikimin e alkoolit.

3367. Kush është përgjegjës nëse personi nuk e ka përdorur rripin e sigurisë?

- Çdo herë shoferi.
- Shoferi nëse personi është i mitur.
- Personi nëse është i moshës madhore.

3368. A duhet të përdorin rripin e sigurisë personat të cilët barten në mjetin e udhëtarëve (veturës)?

- Po, në ulëset e përparme.
- Po, në ulëset e përparme, nëse i ka paraparë prodhuesi.
- Po, vetëm në ulësen e përparme.

3369. Në cilat raste përdoren dritat e shkurtëra?

- Gjatë përballkalimit.
- Gjatë ngasjes në tunel.
- Gjatë kohës deri sa kalon pranë kolonës së organizuar të këmbësorëve.

3370. Si do të veproni nëse mjete i cili vjen përballë i ndez dritat e gjata?

- Shikimin do ta orientoj kah skaji i dajthtë i rrugës.
- Duhet ndezur dritat e gjata.
- Do ta zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes.

3371. Në cilat raste natën në mjetin e parkuar nuk ka nevojë të jenë të ndezura dritat për shënimin e mjetit?

- Në vendet e ndriçuara.
- Në vendparkim.
- Në mjetin e parkuar jashtë rrugës.

3372. Sa metra ndriçojnë rrugën tufa e dritave të gjata të automjetit?

- Së paku 100 m.
- Prej 40 deri 80 m.
- Deri 35 m.

3373. Në cilat rastet mjete nuk duhet t'i ketë të ndezura dritat?

- Mjete i ndalur ose i parkuar në pjesën e ndriçuar të rrugës që shihet qartë nga një largësi e mjaftueshme.
- Mjete i ndalur ose i parkuar në vende të caktuara në rrugë ose jashtë rrugës.
- Mjete i ndalur ose i parkuar në rrugë me intensitet të dobët të trafikut.

3374. Në cilat raste përdoren dritat e shkurtëra ?

- Gjatë përballkalimit, kur mjete tjetër vjen përballë dhe kur njëri nga shoferët e mjetit ndal dritat e gjata dhe i ndez dritat e shkurtra.
- Në pjesën e rrugës me ndriçim rrugor.
- Vetëm gjatë ngasjes në motoudhë dhe autoudhë.

3375. Sa metra ndriçojnë rrugën tufa e dritave të shkurtëra të automjetit?

- Së paku 100 m.
- Prej 40 deri 80 m.
- Deri 35 m.

3376. Kur shoferi i automjetit duhet t'i ketë të ndezura dritat e shkurtra ose dritat e ditës?

- Gjatë tërë kohës së drejtimit.
- Vetëm gjatë kushteve të vështira atmosferike.
- Vetëm natën, nëse rruga nuk ka ndriçim rrugor.

3377. Nën cilat kushte zvogëlohet kontakti (puthitja) i rrotave me rrugë?

- Nëse rruga është e lagur.
- Nëse rruga është e terur.
- Nëse rruga është e mbuluar me borë.

3378. Në cilat vende rruga mund të jetë me baltë dhe e rrëshqitshme?

- Në afërsi dhe në vende të punimeve në rrugë.
- Në kryqëzime me rrugën e dheut.
- Në pjesën e rrugës ku lëvizin shumë mjete.

3379. Cilat janë rreziqet e mundshme gjatë ngasjes në rrugë të drejtë e të gjatë?

- Humbet ndjenja për shpejtësinë.
- Lodhja dhe monotonia.
- Shoferin e nxit për shpejtësi të madhe.

3380. Nën cila kushte zvogëlohet kontakti (puthitja) i rrotave me rrugë?

- Nëse rruga është me baltë.
- Nëse rruga është e mbuluar me gjethe.
- Nëse rruga është e terur.

3381. Cilat forca ndikojnë në mjet?

- Forca tërheqëse.
- Forca centrifugale.
- Forca e frenimit.

3382. Cilat karakteristika të rrugës ndikojnë në rritjen e sigurisë në trafikun rrugor?

- Sinjalizimi i rregullt.
- Rruga me sipërfaqe të rrëshqitshme.
- Pjerrtësia tërthore e përcaktuar drejt.

3383. Cilat forca ndikojnë në mjet?

- Forca anësore.
- Forca e fërkimit.
- Vetëm forca centrifugale.

3384. Në cilat vende të rrugës mund të ketë akull?

- Mbi ura.
- Në vende nën hije të rrugës nëse posaçërisht rruga kalon në vise malore.
- Në tunele.

3385. A është e lejuar që shoferi ta zvogëlojë shpejtësinë me frenim të vrullshëm?

- Jo, në asnjë rast.
- Po, nëse nuk ka pjesëmarrës tjerë në trafik.
- Po, në rast të rrezikut të drejtpërdrejt.

3386. Cilët tregues të drejtimit ndizën gjatë ngasjes prapa ?

- Të majtë.
- Të djathtë.
- Të gjithë treguesit e drejtimit.

3387. Cilat drita aktivizohen me rastin e përdorimit të frenit punues?

- Drita e parkimit.
- Dritat e pozicionit.
- Dritat e frenimit.

3388. Çka duhet të keni parasysh gjatë hyrjes në rrugë nga garazhi?

- Do t'i jap përparësi kalimi vetëm krahut të djathtë.
- Duhet t'i lëshoj të gjitha mjetet që lëvizin nëpër rrugë.
- Duhet t'i lëshoj këmbësoret që lëvizin nëpër trotuar.

3389. Në cilat raste përdoren të gjithë treguesit e drejtimit?

- Gjatë tërheqjes së mjetit në defekt.
- Nëse mjete lëviz për gjysmë më pak se sa shpejtësia që është paraparë për atë pjesë të rrugës.
- Gjatë ngasjes prapa.

3390. Në cilat raste përdoren të gjithë treguesit e drejtimit?

